



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

Ex officio nr. 331/2022

lidhur me përafrimin e dispozitave të sistemit të arsimit të përgjithshëm parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim

Për:

Znj. Arbërie Nagavci, ministre
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Komunat e Republikës së Kosovës

Kopje:

Habit Hajredini, drejtor
Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 9 nëntor 2022

1. QËLLIMI I RAPORTIT

Raporti ka për qëllim vlerësimin e nivelit të zbatimit të dispozitave përkatëse kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve në sektorin e arsimit nga autoritetet dhe institucionet e arsimit të Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) parashikon: (i) Shkollimin themelor publik pa pagesë për fëmijët dhe (ii) mundësi të barabarta për të gjithë për t'u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tyre. Këto dy dispozita kushtetuese ngërthejnë tri aspekte themelore: (i) Sistemi arsimor duhet të ofrojë qasje në arsim, përfshirë arsimin themelor të detyrueshëm; (ii) arsimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe duhet të ofrojë mundësi të barabarta për arsimim; dhe (iii) arsimi duhet të shërbejë për përmbushjen e nevojave themelore dhe specifike të çdo fëmije. Përderisa aspekti i parë i referohet *qasjes ose pjesëmarrjes në arsim*, si një e drejtë themelore dhe (në këtë rast) kushtetuese e njeriut, aspekti i dytë dhe i tretë trajtojnë gjithë përfshirjen dhe rëndësinë e arsimit të ofruar në Kosovë për *zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijëve* sipas nevojave dhe aftësive të tyre specifike. Prandaj raporti heton pjesëmarrjen e fëmijëve, gjithë përfshirjen e institucioneve arsimore dhe rëndësinë e arsimit të ofruar në Kosovë për të përcaktuar nëse ato shërbejnë për ta përmbushur të drejtën e fëmijëve në arsim, si një e drejtë themelore e njeriut.

Pjesëmarrja në arsim - përkufizohet si: *“Shpeshësia me të cilën një nxënës ndjek të njëjtat aktivitete arsimore si nxënësit/studentët e tjerë, kombinuar me intensitetin e përfshirjes që nxënësi e percepton në aktivitetet e ndjekura.”*¹ Ky përkufizim përbëhet nga tre komponentë kryesorë: (i) Ndjekja e shkollimit, (ii) barazia me nxënësit e tjerë, (iii) përfshirja aktive e nxënësve individualë në një mjedis arsimor. Më tej kjo pjesëmarrje përfshin edhe *“nëse mjedisi është i përshtatur dhe pranohet nga fëmija derisa përshkruan intensitetin e përfshirjes ose angazhimit në një aktivitet”*. Në mënyrë që ky mjedis të jetë i favorshëm, duhet të analizohen pesë dimensione me rëndësi², si: disponueshmëria;³ qasshmëria;⁴ përbalueshmëria;⁵ mundësia e përshtatjes/adaptimit;⁶ dhe pranueshmëria⁷ Për qëllime të këtij hetimi, këto pesë dimensione janë përdorur për ta lehtësuar të kuptuarit dhe mjedisin mësimor gjatë vizitave në terren në shkolla.

Përfshirja në arsim - një përkufizim përgjithësisht i pranuar dhe i gjerë i përfshirjes është ai i paraqitur në Deklaratën e Salamankës⁸, i cili thotë: *“Parimi themelor i shkollës gjithëpërfshirëse është që të gjithë fëmijët duhet të mësojnë së bashku, kudo që është e mundur, pavarësisht vështirësive apo dallimeve që mund të kenë. Shkollat gjithëpërfshirëse duhet të kuptojnë dhe t'u përgjigjen nevojave të ndryshme të nxënësve të tyre, duke përshtatur stilet dhe shkallët e ndryshme të të mësuarit dhe duke siguruar arsim cilësor për të gjithë*

¹ M. G. L. A. Gregor R Maxwell, «Inclusion Through Participation: Understanding Participation in the International Classification of Functioning, Disability, and Health as a Methodological Research Tool for Investigating Inclusion.» *Frontiers in Education*, vëll. i 3, nr. June 2018, p. 16, June 2018.

² Këto pesë dimensione kanë rezultuar të rëndësishme në vlerësimin e mjedisit shkollor gjatë vizitave në shkolla si pjesë e këtij hulumtimi. Formulimi i përshkrimit të pesë dimensioneve është modifikuar pak për ta kuptuar më lehtë pa e ndryshuar substancën ose kuptimin.

³ Përshkruan mundësinë objektive për t'u angazhuar në arsim.

⁴ Përshkruan se a mundeni, apo e perceptoni se mundeni, të keni qasje në kontekstin arsimor.

⁵ Mbulon jo vetëm kufizimet financiare, por edhe nëse shpaguhet përpjekjet, si në aspektin e kohës ashtu edhe të energjisë së shpenzuar, për t'u angazhuar në arsim.

⁶ Përshkruan nëse një situatë mund të përshtatet [për nevojat e nxënësve].

⁷ Mbulon pranimin nga njerëzit të pranisë së një personi në një situatë.

⁸ UNESCO, «The Salamanca Statement and Framework,» UNESCO, Paris, 1994.

nëpërmjet kurrikulave të duhura, rregullimeve organizative, strategjive të mësimdhënies, përdorimit të mjeteve dhe partneriteteve me komunitetet e tyre.” Kjo deklaratë rezultoi me një qasje të re në arsim, e cila promovoi integrimin në shkollimin e rregullt të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Megjithatë: “Ndryshe nga synimet, zbatimi i integritit në praktikë nuk eliminoi ndarjen, marginalizimin, diskriminimin apo zhvlerësimin në mjediset e shkollave të zakonshme. Integrimi ishte kryesisht një reformë në nivel të sistemit, duke marrë si të mirëqenë se ndryshimet në sistemin (vendosje) do të ndikonin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në klasë në mënyrën më të mirë për “nxënësit që integroheshin.”⁹ Rreth 15 vite pas fillimit të zbatimit të konceptit të integritit, ky hetim shqyrtoi shkurtimisht rezultatet e mundshme dhe ndikimin që ka pasur qasja e re në shkollimin në Kosovë për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Rëndësia e arsimit- lidhur me rëndësinë e arsimit dhe se për çfarë qëllimesh shërben dhe duhet të shërbejë ai, studiuesit kryesorë të kësaj fushe ndahen në dy grupe: (i) Grupi i parë deklaroi se arsimi duhet t’i shërbejë qëllimit utilitar të zhvillimit ekonomik individual dhe shoqëror. Ai zakonisht u referohet vlerave të jashtme, rezultateve arsimore, kontributeve në zhvillimin ekonomik, ndërtimit të kapitalit njerëzor e kështu me radhë, të gjitha këto që i shërbejnë përfitimeve të përbashkëta shoqërore dhe që i përjashtojnë vlerat e brendshme;¹⁰ (ii) Grupi i dytë fokusohet në nxënësin, duke theksuar: “(...) kuptimi i plotë i motivimit të nxënësit dhe efekteve kontekstuale që ndikojnë në motivim është thelbësor drejt transformimit të shkollave nga të qenit burgje të perceptuara intelektuale, pa rëndësi dhe domethënie personale, në mjedise që mbështesin eksplorimin, mësimnxënien dhe kreativitetin tek të gjithë nxënësit.”¹¹ Andaj arsimi duhet jo vetëm t’i përmbushë prioritetet e autoriteteve shoqërore, por edhe t’i përmirësojë arritjet akademike të nxënësve, motivimin dhe pasionin e vazhdueshëm për të mësuar.¹²

Përkufizimi i fundit ishte ai që i dha drejtim hetimit për këtë raport, pasi është në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, e cila fokusohet në zhvillimin e fëmijëve sipas aftësive dhe nevojave të tyre specifike. Hetimi synon t’i adresojë tri pyetje kryesore: (i) A ofrohet qasje e barabartë në arsimin publik pa pagesë për të gjithë fëmijët në Kosovë, si një nga të drejtat themelore të njeriut? (ii) A është sistemi arsimor mjaft gjithëpërfshirës dhe a ndihen të gjithë nxënësit mirë dhe të pranuar brenda sistemit? (iii) A ofrohet arsimim adekuat dhe a shërben ai për zhvillimin e personalitetit, talentit dhe aftësive mendore dhe fizike të nxënësve në potencialin e tyre maksimal dhe bazuar në nevojat dhe aftësitë e tyre specifike?

2. BAZA LIGJORE

Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës dhe sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit¹³, (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit), pos të tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- “Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose

⁹ P. Haug, «Understanding inclusive education: ideals and reality,» *Scandinavian Journal of Disability Research*, vëll. i 19, nr. 3, pp. 206-217, 2017.

¹⁰ M. Gibbons, «Relevance of Higher Education in the 21st Century,» The World Bank, Washington, 1998.

¹¹ E. M. A. Rich Gilman, «Motivation and its relevance to school psychology: An introduction to the special issue,» *Journal of School Psychology*, vëll. i 44, nr. 5, pp. 325-329, 2006.

¹² J. Dewey, *The School and Society*, Chicago: The Chicago University Press, 1900.

¹³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.16/, 26 qershor 2015¹³, Prishtinë: <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>.

mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);

- *Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);*
- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i Ligjit për Avokatin e Popullit);*
- *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit);*
- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit)."*

3. KORNIZA LIGJORE

3.1. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF)¹⁴ - KDF-ja rekomandon ushtrimin e së drejtës së arsimit *"në mënyrë progresive dhe mbi bazën e mundësive të barabarta"*.¹⁵ E drejta për arsimim karakterizohet si një *"e drejtë e aftësisimit-fuqizimit"*. Një e drejtë e tillë i ofron individit më shumë kontroll për drejtimin e jetës së tij apo saj, në veçanti kontrollin mbi veprimet e shtetit kundrejt individit. Me fjalë të tjera, ushtrimi i së drejtës së arsimit i ndihmon fëmijët në zhvillimin e plotë të personalitetit, të talenteve dhe të aftësive të tyre mendore e fizike¹⁶, në mënyrë që t'i përfshijnë në mirat e të drejtave të tjera. Konventa njihet nevojat e veçanta të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe parasheh që ndihma e dhënë nga shteti duhet të jepet falas sa herë të jetë e mundur, në mënyrë që fëmijëve me aftësi të kufizuara t'u mundësohet të marrin arsimim në mënyrë efektive, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese, në mënyrë që ata ta sigurojnë një integritet shoqëror dhe zhvillim individual sa më të plotë, përfshirë zhvillimin e tyre kulturor dhe shpirtëror.¹⁷

Marrë parasysh rëndësinë e së drejtës për arsim, ajo fillimisht ishte shpallur për herë të parë në vitin 1948 përmes Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNj)¹⁸, më vonë e konkretizuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

3.2 Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) - në Protokollin shtesë nr. 11, në nenin 2 të saj [E drejta për arsimim], thuhet: *"Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje*

¹⁴ Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1989, në nenet 28 dhe 29, në: [https://www.unicef.org/tfvr/maqedonia/CRC_albanian_language_version\(3\).pdf](https://www.unicef.org/tfvr/maqedonia/CRC_albanian_language_version(3).pdf) Konventa është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë dhe ka përparësi zbatimi krahasuar me aktet e tjera ligjore vendore në bazë të nenit 22 të Kushtetutës.

¹⁵ KDF, neni 28

¹⁶ KDF, neni 29.

¹⁷ KDF, neni 23.

¹⁸ E drejta për edukim garantohet me nenin 26 të DUDNj-së.

me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.” Këto instrumente ndërkombëtare deklarojnë se të paktën arsimit fillor është falas dhe i detyrueshëm, ndërsa arsimit i mesëm dhe i lartë do të bëhen në mënyrë progresive të arritshme për të gjithë, edhe pse jodomosdoshmërisht falas. Pra edukimi është parë si faktor kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm të njeriut, përmes të cilit rritet përmirësimi i cilësisë së jetës në nivel individual, familjar, shoqëror dhe global.

3.2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës – Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke përfshirë këtu edhe të drejtat e fëmijës. Për më tepër, Kushtetuta në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] ka paraparë: *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantoohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.”* Gjithashtu ka përcaktuar se zbatim të drejtpërdrejtë kanë dy konventat e lartpërmendura ndërkombëtare. Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha institucioneve që t’i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut¹⁹, parim që vlen për të gjithë, përfshirë edhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (në tekstin e mëtejshëm: MASHTI) dhe komunat, duke realizuar të drejtën e fëmijëve për arsim në pajtim me dispozitat ligjore dhe me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kushtetuta obligon institucionet që të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët t’i marrin në interesin më të mirë të fëmijëve, si dhe garanton arsimimin, si e drejtë e përgjithshme e njeriut që e gëzon çdo person.²⁰

Megjithatë, tiparet dhe rezultatet e sistemit të arsimit parauniversitar maten duke pasur parasysh dispozitat e qarta kushtetuese, që rregullojnë të drejtat e fëmijëve për arsim dhe detyrimet e shtetit për t’i ofruar dhe mbrojtur ato. Në Kapitullin II, Të Drejtat dhe Liritë Themelore, neni 47 [E Drejta për Arsimin] i Kushtetutës përcakton: *“(i) Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike.(ii) Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”*

Paragrafi i dytë i këtij neni është shumë i rëndësishëm pasi, përtej ofrimit të thjeshtë të arsimit, ai thekson nevojën për t’i ofruar çdo individ një arsim cilësor që përmbush *“aftësinë dhe nevojat specifike”* të tij, si të drejta të patjetërsueshme dhe të pacenueshme në bazë të rendit juridik të Republikës së Kosovës. Kjo dispozitë përcakton përgjegjësi shtesë për autoritetet shtetërore për llojin e arsimit që duhet t’u ofrohet të gjithë fëmijëve dhe të rinjve të Republikës së Kosovës.

Kushtetuta në nenin 47 përcakton tri aspekte themelore në këto dy dispozita: (i) sistemi arsimor duhet të ofrojë qasje në arsim, përfshirë arsimin themelor të detyrueshëm, (ii) arsimit duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe duhet të ofrojë mundësi të barabarta për arsimim, dhe (iii) arsimit duhet të shërbejë për të përmbushur nevojat themelore dhe specifike të çdo fëmije. Përderisa aspekti i parë i referohet *qasjes ose pjesëmarrjes në arsim* si një e drejtë themelore dhe (në këtë rast) kushtetuese e njeriut, aspekti i dytë dhe i tretë trajtojnë gjithë përfshirjen dhe rëndësinë e arsimit të ofruar në Kosovë për *zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijëve* sipas nevojave dhe aftësive të tyre specifike. Prandaj raporti heton pjesëmarrjen e fëmijëve, gjithëpërfshirjen e institucioneve arsimore dhe rëndësinë e arsimit të ofruar në Kosovë për të

¹⁹ Kushtetuta, neni 21.

²⁰ Kushtetuta, neni 50(4) dhe 47 (1)

përcaktuar nëse ato shërbejnë për ta përmbushur të drejtën e fëmijëve dhe të të rinjve në arsim, si një e drejtë themelore e njeriut dhe në përputhje me tekstin dhe frymën e kornizës kushtetuese në Kosovë.

Përveç pjesës së përgjithshme, Kushtetuta në Kapitullin III, përkatësisht në nenin 59, u referohet në mënyrë specifike "Të drejtave të komuniteteve për arsimim", që trajton në mënyrë të veçantë të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre: "*Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet: (2) të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjedhjes së tyre; (3) të marrin arsimim publik parafillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj, ku pragu për themelimin e paraleleve a shkollave të veçanta për këtë qëllim, do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore.*" Në këta paragrafë përmenden konkretisht masat afirmative që shërbejnë për ofrimin e shërbimeve arsimore për komunitetet, në këtë rast duke ulur kriteret për krijimin e klasave apo shkollave për komunitetet pakicë.

Qasja e Kushtetutës është në harmoni të plotë me dokumentet dhe trendet përkatëse ndërkombëtare. Një qasje e ngjashme theksohet në hyrjen e Raportit PISA të OECD-s mbi arsimin në vendet e Ballkanit Perëndimor²¹, ku theksohet: "*Nëse të gjithë fëmijët duan të arrijnë potencialin e tyre të plotë në jetë, të gjithë fëmijët duhet të kenë mundësi të barabarta për të marrë një arsimim cilësor. Rëndësia kritike e arsimit për perspektivën dhe prosperitetin e individëve, komuniteteve dhe kombeve të tëra është njohur në Agjendën globale të Arsimit 2030 në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), me OZHQ4 që kërkon arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë.*"

Aspektet kryesore të theksuara janë arsimit gjithëpërfshirës dhe barazia duke nënkuptuar masa afirmative për të siguruar përfitim të barabartë nga arsimit dhe arsim cilësor për të gjithë. Një dimension i ri në qasjen ndërkombëtare ndaj arsimit në Agjendën e Arsimit 2030 ka qenë theksi mbi arsimin cilësor për të gjithë. Kjo do të thotë se vetëm ofrimi i arsimit për të gjithë është i pamjaftueshëm dhe joadekuat për t'i përballuar sfidat dhe ndërlikimin e jetës në epokën e re të digjitalizuar. Kjo vlen veçanërisht në kontekstin e aspiratës për të arritur "*perspektivën dhe prosperitetin e individëve, komuniteteve dhe kombeve të tëra.*" Nevoja për zbatimin e kornizës afirmative ligjore në Kosovë konfirmohet në Raportin e BE-së për Kosovën për vitin 2021, ku theksohet: "*Sa i përket të drejtave të fëmijës, korniza ligjore e Kosovës është kryesisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, por zbatimi mbetet i kufizuar.*"

3.3. Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF)²² – LMF-ja në nenin I ka përcaktuar qëllimin e vet: "*(...) 1.2. të mbrojë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës; 1.3. të garantojë dhe sigurojë përgjegjësitë e prindërve, familjes, organit të kujdestarisë, shoqërisë dhe të shtetit në kujdesin, mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijës bazuar në interesin më të mirë të fëmijës; (...).*" LMF-ja në mënyrë specifike adreson të drejtat e fëmijës duke përfshirë edhe dispozita të

²¹ OECD, Foreword from UNICEF - in Education in the Western Balkans: Findings from PISA, Paris: OECD Publishing, 2020, p. 1.

²² Ligji nr. 06/I-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.14/17, korrik 2019, Prishtinë: LMF gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844.

veçanta që adresojnë arsimimin e fëmijëve. Konkretisht neni 37, paragrafi 2, i LMF-së thekson: *“Ministria përkatëse për arsim duhet të sigurojë qasje gjithëpërfshirëse dhe frekuentim të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tyre për të kuptuar në të gjitha nivelet e arsimit para universitar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm.”* Përveç asaj që u tha më lart, ky paragraf fokusohet në aftësinë e nxënësit, një referencë që duhet marrë parasysh gjatë planifikimit dhe organizimit të mësimi për fëmijët dhe për të rinjtë me aftësi të kufizuara. Pra, përmbajtja e kurrikulës duhet të përshtatet për t'i shërbyer më së miri arritjes së potencialit të këtyre nxënësve në bazë të aftësive të tyre.

3.4. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovë (LAPRK)²³ – LAPRK-ja rregullon edukimin, arsimin dhe aftësimin parauniversitar nga niveli 0 deri në 4 i ISCED-it²⁴, duke përfshirë arsimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe të të rriturve që marrin kualifikime në këto nivele. Për më tepër neni 1, paragrafi 2, i LAPRK-së i referohet dispozitës kushtetuese për të drejtën për arsimim duke thënë se qëllimi i arsimit dhe i aftësimi parauniversitar përfshin zhvillimin e plotë të personalitetit, dhuntisë dhe aftësive mendore dhe fizike të nxënësit. I njëjti parim përsëritet në nenin 3, paragrafi 3, duke theksuar: *“Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera (...) për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.”* Neni 9 i këtij ligji po ashtu parashih që arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (niveli ISCED 1 dhe 2) janë arsim i detyrueshëm për fëmijët në Kosovë.

3.5. Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (LMPDKPRK)²⁵ – LMPDKPRK-ja në nenin 3, paragrafi 4, përcakton masat afirmative për barazi të plotë në arsimimin e komuniteteve: *“Republika e Kosovës ndërmerr masa të tilla afirmative të cilat mund të jenë të nevojshme për promovimin e barazisë së plotë dhe efektive në të gjitha sferat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore, duke përfshirë arsimin, median, shëndetësinë dhe shërbime të tjera publike. Veprimet e tilla ofrohen në mënyrë të barabartë për të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre bazuar vetëm në nevoja.”* Më tutje neni 8, paragrafi 11, rregullon si vijon: *“Qeveria e Republikës së Kosovës siguron qasje të barabartë të personave që iu përkasin komuniteteve në arsimin e lartë në nivelin universitar. Në këtë drejtim, Qeveria krijon masa të veçanta për të siguruar pranimin e kandidatëve që vijnë nga shkollat e komuniteteve në institucionet e arsimit të lartë dhe universitar.”*, duke theksuar përfshirjen e komuniteteve në arsimin e lartë.

3.6. Ligji për Edukimin Parashkollor (LEP)²⁶ – LEP-i në nenin 1 përcakton: *“Edukimi parashkollor i referohet edukimit të hershëm nga edukatorët e njohur për fëmijët e moshës parashkollore. Edukimi i fëmijëve me nevoja të veçanta i referohet edukimit të posaçëm të tyre që kanë nevojë ose dëmtime shqisore, dëmtime fizike, vështirësi në të nxënë, çrregullime*

²³ Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (GZRK) më 16 shtator 2011; <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>

²⁴ LAPRK, neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 1.21.

²⁵ Ligji nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: VITI III / nr. 28 / 04 qershor 2008.

²⁶ Ligji nr.02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor, Gazeta Zyrtare e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/Prishtinë: Viti I/Nr1/01Qershor 2006; <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2401>

sociale, emocionale dhe në komunikim. Gjithë përfshirja (shih Konventa e të Drejtave të Fëmijës, neni 2)- Shtetet palë angazhohen të respektojnë të drejtat e përmendura në këtë Konventë dhe t'ia garantojnë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e tyre, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë. (...). Tutje neni 4 i LEP-it përcakton se edukimi në institucione parashkollore do të bazohet në këto parime: "(a) Barazia; (b) Gjithë përfshirja; (c) Demokracia; (d) Autonomia e personelit; (e) Profesionalizmi dhe përgjegjësia; (f) Mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marrë parasysh ndryshimet në mes të fëmijëve; (g) E drejta për të qenë ndryshe; (h) Zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijëve."

LEP-i është miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2006 dhe si i tillë është një nga ligjet më të vjetra në Kosovë. Ligji aktual përcakton se arsimit parashkollor është përgjegjësia e komunave, por në të njëjtën kohë parashihet që ky nivel arsimor të financohet nga buxheti i Kosovës. Ligji gjithashtu parashikon (në nenin 6) përfshirjen në institucionet parashkollore të fëmijëve me nevoja të veçanta, edhe pse nuk parashikon mekanizma apo procedura për vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta apo fonde shtesë dhe mbështetje për institucionet parashkollore për këtë qëllim. I njëjti u bën thirrje (në nenin 48) autoriteteve arsimore të Kosovës të sigurojnë që të gjithë fëmijët e moshës 5-6 vjeç të përfshihen në klasën parafillore deri në vitin 2010. Ky synim pothuajse është arritur pasi për disa vite Kosova ka pasur një përfshirje përmbi 85 % në klasën parafillore.

4. POLITIKAT DHE PLANET STRATEGJIKE

4.1. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 (PSAK)²⁷- PSAK-u është në përputhje me frymën kushtetuese në atë që i jep prioritet përfshirjes dhe sigurimit të cilësisë brenda një kornize që ka nxënësin në qendër. PSAK-u përcakton qëllime dhe objektiva strategjike shumë të qarta në shtatë fusha parësore të ndërhyrjes. Pesë nga këto fusha të intervenimit, që fokusohen në arsimin e përgjithshëm parauniversitar dhe përbëjnë bazën mbi të cilën analizohet e arritura e sistemit në promovimin e zhvillimit të fëmijëve në arsim në Kosovë, janë: 1. Pjesëmarrja dhe përfshirja; 2. Menaxhimi i sistemit arsimor; 3. Sigurimi i cilësisë; 4. Zhvillimi i mësimdhënësve; 5. Mësimdhënia dhe mësimnxënia.

Në fushën e përfshirjes (1) PSAK-u parasheh: (i) krijimin e një "sistemi të integruar për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave që gjithashtu do të mundësojë monitorimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe fëmijët që braktisin shkollën; (ii) përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, si përmes ofrimit të programeve të trajnimit për gjithëpërfshirje, ashtu edhe përmes zbatimit të ideve dhe qëllimeve themelore të Kornizës Kurrikulare të Kosovës."

Menaxhimi i Arsimit (2) është i rëndësishëm për rezultatin e sistemit dhe PSAK-u parasheh: (i) ndërtimin e kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet dhe (ii) decentralizimin dhe ngritjen e kapaciteteve në nivel lokal/shkollor të këshillave drejtues të shkollave, në mënyrë që të demokratizohet dhe që vendimmarrja të silllet më afër përdoruesve fundorë të arsimit të ofruar.

²⁷ https://krveministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Plani_Strategjik_i_Arsimit_në_Kosovë.pdf

Për sa i përket Sigurimit të cilësisë (3), si një nga fushat që mund të shërbejë për zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore për zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijëve sipas nevojave të tyre specifike, parashikohet: (i) zhvillimi i një sistemi funksional të sigurimit të cilësisë, në përputhje me standarde ndërkombëtare dhe për këtë qëllim; (ii) ajo përcakton ndërtimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e nevojshme për funksionalizimin e çdo sistemi të ri të sigurimit të cilësisë.

Pavarësisht vendosjes së nxënësit në qendër, mësimdhënësit janë ende shumë të rëndësishëm për zbatimin adekuat të çdo politike. Në zhvillimin e mësimdhënësve (4) fokusi kryesor është ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, i cili do të kontribuonte në zbatimin e reformave në shkollë dhe do të ndikonte drejtpërdrejt në përmirësimin e rezultateve të nxënësve.

Në mësimdhënie dhe mësimnxënie (5) MASHTI ka planifikuar ta ngrejë në maksimum mësimnxënien përmes mësimdhënies cilësore, zbatimit të kurrikulave të bazuara në kompetenca dhe duke përdorur burime cilësore të mësimdhënies. Ky seksion i PSAK-ut merret me kurrikulat, me tekstet shkollore, me pajisjet teknologjike, me burimet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies (përfshirë ato elektronike) dhe të mësuarit e nxënësve.

Megjithatë vlen të theksohet se Rrjeti Kosovar për Arsim dhe Punësim (KEEN) -²⁸ lidhur me nivelin e zbatimit të PSAK-ut ka konstatuar: “Nga 264 masat e planifikuara në kuadër të 7 objektivave strategjike të PSAK-ut, deri më sot vetëm 19 janë realizuar plotësisht sipas planit (7%), 87 janë zbatuar vetëm pjesërisht (33%), ndërsa 158 masa të planifikuara mbeten larg realizimit sipas planit (60%).” Kjo vë në pah zbatimin joadekuat të kornizës ligjore mbi arsimin në Kosovë.

4.2. Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve 2019-2023 (SDF)²⁹- SDF-ja paraqet një plan shumësektorial i cili trajton të drejtat e fëmijëve nga perspektiva e një numri institucionesh qeveritare dhe sektorësh jetësorë. Një objektiv strategjik (4) dhe rezultatet përkatëse (4.1.-4.3.) i dedikohen arsimit. Ky objektiv strategjik parashikon të sigurojë “përfshirjen e fëmijëve në shërbimet e integruara të zhvillimit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme”. Rezultatet e pritshme parashikojnë rritjen e investimit për përmirësimin e përfshirjes në shërbimet e edukimit në fëmijërinë e hershme (dhe parafillor), si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore në këtë nivel arsimor.

Treguesit për monitorimin e arritjes së këtyre rezultateve janë përafruar me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ), që parashikojnë përfshirjen e fëmijëve parashkollorë në ofrimin e shërbimit institucional deri në vitin 2030. Pastaj janë zhvilluar tregues specifikë për Strategjinë, që përfshijnë: numrin e mësimdhënësve të trajnuar për arsimin parashkollor, numrin e qendrave të komunitetit që ofrojnë shërbime për edukim në fëmijërinë e hershme, numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në qendrat burimore (ish-shkollat speciale), dhe numrin e fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në institucionet e arsimit parashkollor. Këta janë tregues dhe masa shumë të dobishme për përmirësimin e gjendjes së fëmijëve në Kosovë, por caktimi i vitit 2030 si vit për arritjen e përfshirjes adekuate në format e organizuara të edukimit në fëmijërinë e hershme është vit tepër i largët për të ndikuar në jetën e fëmijëve dhe në edukimin e tyre.

²⁸ Rrjeti Kosovar për Arsim dhe Punësim – KEEN. Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë në vitin 2017 - Raport vlerësimi, BE & KEEN, Prishtinë, 2017.

²⁹<https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/08/Alb-Track-Changes-Strategjia-per-te-drejtat-e-femijeve-FINAL-12032019.pdf>

4.3. Korniza Kombëtare e Kurrikulës e Kosovës (KKK)³⁰-KKK-ja është e bazuar në kompetenca ku parimet kryesore të saj janë: (a) përfshirja, (b) zhvillimi i kompetencave të nxënësve, (c) mësimdhënia dhe mësimnxënia e integruar, (d) autonomia dhe fleksibiliteti i shkollës dhe (e) përgjegjësia dhe llogaridhënia në nivel të institucionit dhe sistemit.

Më tej ky dokument përshkruan konceptin e kompetencave duke i përcaktuar ato si një "sistem të integruar dhe koherent i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të zbatueshme dhe që mund të barten, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve të përballen me sfidat e epokës digjitale dhe të ekonomisë së tregut, që bazohet në njohuri në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura".³¹ Më tutje, korniza përcakton shtatë kompetencat kryesore që do të zhvillohen nga sistemi arsimor i Kosovës, përfshirë: kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit, kompetencën e të menduarit, kompetencën e të mësuarit, kompetencën për jetën, punën dhe mjedisin, kompetencën personale dhe kompetencën qytetare. Kjo kornizë është plotësisht në përputhje me trendet ndërkombëtare në arsim dhe me dispozitat afirmative të kornizës kushtetuese dhe ligjore të Kosovës për arsimin. Megjithatë, hetimi ynë ka gjetur mospërputhje të konsiderueshme mes asaj që paraqet ajo dhe praktikave që ndodhin në shkollë. Kjo mund të ilustron shkurtimisht me (i) natyrën e mësimdhënies në shkollat e Kosovës, e cila është larg nga një mësimdhënie dhe mësimnxënie e integruar. Mospërputhja midis parimeve kurrikulare dhe përkthimit të tyre në praktikën shkollë pasqyrohet edhe brenda dokumentit. Në radhë të parë, planet mësimore përcaktojnë se mësimdhënia duhet të organizohet në lëndë (duke arritur deri në 18 lëndë brenda një viti shkollor), në vend të fushave kurrikulare (shkencë, matematikë, shkenca shoqërore e kështu me radhë) siç kërkohet me parimet e kurrikulave të bazuara në kompetenca. Hetimi gjithashtu ka vërejtur mospërfillje të dispozitave kurrikulare në praktikën aktuale. Kjo do të thotë se kurrikula thekson se fëmijët e klasës parafilllore duhet të kalojnë së paku 18 orë mësimi nga 45 minuta në javë në shkollë, ndërsa në praktikë ata nuk kalojnë më shumë se dhjetë orë në javë.³²

5. PJESËMARRJA NË ARSIM

Ky seksion trajton aspektet kryesore të pjesëmarrjes në arsimin parauniversitar për arsimin parashkollor, arsimin fillor dhe të mesëm të ulët dhe arsimin e mesëm të lartë. Sipas klasifikimit më të fundit të arsimit në Kosovë³³, arsimit i përgjithshëm parauniversitar organizohet në nivelet 0, 1, 2 dhe 3, ku nivelet 1 (fillor) dhe 2 (i mesëm i ulët) janë nivele të arsimit të detyrueshëm, ndërsa nivelet 0 (parashkollor dhe parafillor) dhe 3 (i mesëm i lartë) nuk përfshihen në arsimin e përgjithshëm të detyrueshëm.

Obligimi i arsimit të detyrueshëm duket se ka një ndikim të konsiderueshëm në nivelin e pjesëmarrjes në arsim, pasi nivelet 0 dhe 3 shënojnë nivele më të ulëta të pjesëmarrjes në arsim krahasuar me nivelet "e detyrueshme" 1 dhe 2.

Sipas të dhënave në dispozicion të MASHTI-t, në arsimin parauniversitar në Kosovë janë të përfshirë 327 676 fëmijë dhe të rinj (duke përfshirë shkollat e mesme profesionale). Prej tyre, 246 515 janë duke ndjekur ndonjë formë të arsimit të detyrueshëm në klasat 1-9 (nivelet 1

³⁰ MASHT, Korniza e Kurrikulumit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë: MASHT, 2016, f. 15 dhe 25.

³¹ Po aty.

³² MASHT, Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës, Prishtinë, MASHT, 2016, f. 95.

³³ MASHTI, «Struktura Kombëtare e Arsimit dhe Fushat e Studimit në Kosovë - sipas ISCED 2011 dhe ISCED 2013», MASHTI, Prishtinë 2022.

dhe 2). Derisa shkalla e përgjithshme e regjistrimit dhe përfshirja në arsimin e detyrueshëm (klasat 1-9) është në nivel të njëjtë me vendet e tjera në rajon dhe në Evropë, ka disa probleme kritike lidhur me pjesëmarrjen në arsimin parashkollor (nën 10% e fëmijëve) dhe në arsimin e mesëm të lartë (rreth 85%)³⁴ (Shih shtojcën 1 të raportit Shifrat për popullatën e nxënësve në Kosovë sipas niveleve).

Koha mësimore në shkollë - Kosova ka nivele të larta të pjesëmarrjes në arsimin e përgjithshëm parauniversitar. Megjithatë, siç do të shohim në seksionin për klasën parafillore në Kosovë, shifrat e pjesëmarrjes nuk pasqyrojnë domosdo kohën që nxënësit e kalojnë në shkollë dhe përfitimet që ka ajo pjesëmarrje për zhvillimin e nxënësve. Për ilustrim, shkalla e lartë e përfshirjes (rreth 90%) në mësimin parafilor në Kosovë duhet marrë me rezervë pasi shumica e fëmijëve të kësaj klase kalojnë vetëm dy orë në ditë në shkollë në vend të së paku katër orëve të parapara me kornizën kurrikulare. Prandaj është e rëndësishme që të analizohet shkurtimisht koha mësimore që nxënësit e kalojnë në shkollë.

Sipas të dhënave të Bankës Botërore³⁵, nxënësit në vendet e Ballkanit Perëndimor vazhdojnë të kalojnë më pak kohë në shkollë sesa fëmijët në vendet e BE-së dhe OECD-s. Sa më pak kohë që fëmijët kalojnë në shkollë, aq më pak ka gjasa që të arrijnë rezultate optimale në zhvillimin e tyre. Ky raport tregon se koha mësimore në vendet e Ballkanit është më e ulëta krahasuar me mesataren e BE-së dhe OECD-s.

Të dhënat nga Banka Botërore nuk përfshijnë Kosovën, mirëpo ekipi i MASHTI-t, i angazhuar në vlerësimin afatmesëm të PSAK-ut 2017-2021, ka bërë llogaritjen e kohës mësimore në shkollë edhe për nxënësit kosovarë. Ata theksojnë se mësimdhënësit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët japin mësim rreth 408 orë brenda një viti shkollor dhe mësimdhënësit e arsimit të mesëm të lartë mesatarisht 691 orë, në përputhje me dispozitat e rregullores së MASHTI-t. Mesatarja e përgjithshme për mësimdhënësit e arsimit parauniversitar në Kosovë është 539 orë³⁶, e cila është në nivelin më të ulët në rajon së bashku me shifrat e Malit të Zi dhe të Shqipërisë.

Numri i ulët i orëve mësimore është burim shqetësimi për arsimin, për shkak se shkollat në Kosovë zakonisht punojnë në dy ndërrime, dhe kjo nuk mundëson kohë të mjaftueshme në shkollë për nxënësit. Për shkak të trendeve demografike në vitet e fundit, nxënësit nga shkollat në zonat rurale janë larguar për në qytete ose jashtë vendit dhe tani këto shkolla punojnë me një ndërrim.³⁷ Në qytete shkollat ndonjëherë punojnë me dy apo edhe me tri ndërrime. Si rezultat orët e mësimit shpesh shkurtohen në 40 apo edhe në 35 minuta (në vend të 45 minutave të parashikuara) për t'i liruar klasat për ndërrimin tjetër. Ky numër i ulët i orëve shkollorë për klasat 1-12 ndjek një model të ngjashëm me numrin e orëve që fëmijët kalojnë në klasën parafillore në shumicën e shkollave të Kosovës. Si përfundim, ka një mospërputhje mes praktikës dhe politikave në nivel kombëtar. Andaj autoritetet duhet të rishikojnë kohën e mësimin në shkollat e Kosovës, përfshirë edhe klasën parafillore, nëse duan që shkollimi t'i shërbejë qëllimit të tij (për zhvillimin e nxënësve) siç parashihet në politikat kombëtare.

³⁴ Informatat e siguruar nga MASHTI, datë 21 mars 2021.

³⁵ World Bank Group, "The Economic and Social Impact of Covid 19- Education," World Bank Group, Washington, Spring 2020.

³⁶ MASHTI, «Raporti i Vlerësimit Vjetor - 2018 për Zbatimin e PSAK 2017-2021», MASHTI, Prishtinë 2019. Ky dokument është vënë në dispozicion përmes emailit nga staffi përgjegjës i MASHTI-t në shkurt të vitit 2022.

³⁷ Madje edhe në ato raste, mësimdhënësit dhe nxënësit në shkollat rurale thjesht shkojnë në shtëpi në mesditë, në vend se të angazhohen në aktivitete të tjera kurrikulare dhe jashtë-kurrikulare.

5.1. Pjesëmarrja në arsimin parashkollor

Arsimi në fëmijërinë e hershme ose nënsektori i arsimit parashkollor në Kosovë është një nga nivelet më të cenueshme të arsimit pasi nuk paraqitet si duhet në të gjitha aspektet kryesore të funksionimit: përfshirja, cilësia dhe njohja e hershme e aftësisë së kufizuar. Për më tepër, ekziston problemi i vazhdueshëm i mungesës së të dhënave dhe i informacioneve të besueshme për këtë nivel të arsimit, veçanërisht në lidhje me të dhënat se si funksionon sektori privat në këtë nivel të arsimit.

Në klasifikimin e tij më të fundit të niveleve të arsimit sipas sistemit ISCED 2011 për klasifikimin e arsimit³⁸, MASHTI e ka përcaktuar strukturën e mëposhtme për arsimin parashkollor dhe parafillor (niveli 0) (shih Shtojcën 2 të raportit, Hartëzimi i arsimit parashkollor). Siç mund të shihet në tabelë, ky nivel i arsimit në Kosovë nuk përfshihet në arsimin e obligueshëm pa pagesë dhe, siç do të shihet më vonë në këtë raport, kjo mund të jetë një prej arsyeve të përfshirjes së ulët në këtë nivel të arsimit.

5.2. Përfshirja në arsimin parashkollor

Sipas të dhënave që ka në dispozicion MASHTI³⁹, 10.311 fëmijë ose 6.7% e numrit të fëmijëve të moshës parashkollore (0-4) në Kosovë janë të përfshirë në ndonjë lloj të arsimit parashkollor të ofruar në Kosovë. Në të njëjtën kohë shifra kumulative (32.397) për fëmijët e moshës 0-5 vjeç (<6) në institucionet parashkollore arrin në 19.5%, falë pjesëmarrjes më të lartë (87%) të fëmijëve në klasën parafillore (mosha 5) (shih Shtojcën 3 të raportit - Pjesëmarrja në arsimin parashkollor dhe parafillor publik dhe privat).

Përfshirja e lartë në klasën parafillore mund të shpjegohet me faktin se ajo organizohet falas në mbi 1000 shkolla në Kosovë, të cilat janë të shpërndara në të gjitha vendbanimet e Kosovës duke u ofruar në këtë mënyrë qasje të lehtë fëmijëve dhe prindërve të tyre. Një arsye tjetër mund të jetë fakti se shkollat financohen nga buxheti qendror që u shpërndahet të gjitha komunave në bazë të një formule të financimit të shkollave, duke siguruar kështu bazën për financimin e qëndrueshëm të kësaj klase (parafillore). Përveç formulës së financimit të shkollave, buxheti qendror siguron fonde shtesë për Grantin Specifik të Arsimit për komunat për të mbuluar shpenzimet për mësuesit/edukatorët parashkollorë. Kështu, Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) për vitin 2022⁴⁰ tregon se janë ndarë 1.95 milion euro për Grantin Specifik të Arsimit për komunat për klasën parafillore duke siguruar edhe 286 edukatorë aktivë që punojnë me fëmijët e moshës 4-5 vjeç.

Qysh në vitin 2001 financimi i arsimit parashkollor publik u bart nga autoritetet qendrore për në nivelin komunal. Aktualisht arsimi parashkollor publik financohet nga dy burime: (i) nga buxhetet e pakta komunale dhe (ii) përmes pjesëmarrjes (me 35€ deri 50€ në muaj) nga prindërit e fëmijëve të regjistruar.

Për shkak të trysnisë së nevojave më të menjëhershme (si: shërbimet komunale dhe infrastruktura), arsimi parashkollor rrallëherë shihet si një ndër prioritetet kryesore të kryetarëve të komunave dhe të administratës. Në anën tjetër, shumica e popullsisë së Kosovës nuk mund të përballojë të paguajë ndërmjet 30-50 euro në muaj për të dërguar një fëmijë në një institucion parashkollor. Kjo shumë rritet për familjet që kanë më shumë se një fëmijë në

³⁸ MASHTI, «Struktura Kombëtare e Arsimit dhe Fushat e Studimit në Kosovë - sipas ISCED 2011 dhe ISCED 2013», MASHTI, Prishtinë 2022.

³⁹ MASHTI, «Statistikat e Arsimit 2020-2021», MASHTI, Prishtinë 2021.

⁴⁰ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/DD1F926B-A37E-4469-AD25-1121EDAEC6CD.pdf>

moshën parashkollore. Për familjet më të varfëra, kopshtet ofrojnë sistemim pa pagesë të financuar nga komuna. Komunat këtë sistemim e ofrojnë për fëmijët e familjeve në nevojë që fitojnë një vend përmes shortit të organizuar nga kopshtet për të siguruar mundësi të njëjtë për regjistrim në një situatë të kapacitetit të kufizuar. Megjithatë, vetëm ekzistimi i pagesës prej 30-50 eurosh mund të dekurajojë familjet në nevojë madje edhe të aplikojnë për regjistrimin e fëmijëve të tyre në kopsht. Përveç kësaj, vijimi i arsimit parashkollor nënkupton edhe transport shtesë për të shkuar dhe për t'u kthyer nga kopshti (të cilat nuk janë gjithmonë në dispozicion në lagjen e afërt), më shumë rroba për fëmijën dhe angazhim me edukatoren. Duke i parë këto implikime, familjet në gjendje jo aq të mirë ekonomike zgjedhin të angazhojnë prindërit ose gjyshërit e tyre në vend se t'i dërgojnë fëmijët në kopshte. Në zonat urbane, ku ka një interesim më të madh për shërbimet parashkollore dhe të kujdesit ditor, ka një mungesë të konsiderueshme të kapaciteteve të akomodimit që ofrohen nga autoritetet publike komunale ose nga institucionet private.⁴¹

MASHTI po ashtu ofron të dhëna për përfshirjen e fëmijëve të moshës 3-5 vjeç (përfshirë klasën parafilllore), që arrin në 36.4% të popullsisë së fëmijëve për të tri grupet.

Pavarësisht përqindjes më të lartë (36.4) të arritur kur llogaritet numri i fëmijëve në klasën parafilllore, Kosova ende mbetet shumë prapa nivelit të përfshirjes krahasuar me vendet e rajonit, të BE-së apo të OECD-s. Të dhëna të ngjashme rreth përfshirjes së fëmijëve të moshës mbi tre vjeç (3-5) në vendet e OECD-s dhe BE-së tregojnë se Kosova ka mbetur shumë prapa, rreth 50 pikë të përqindjes, vendeve të BE-së që kanë një shkallë mesatare të përfshirjes prej 87% dhe vendeve të OECD-s me shkallë mesatare prej 90% të fëmijëve të moshës 3-5 vjeç, të përfshirë në një lloj edukimi parashkollor.⁴²

Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga Komisioni Evropian⁴³, edhe vendet e rajonit kanë shkallë më të lartë të përfshirjes së kësaj grup-moshe sesa Kosova. Më konkretisht, Serbia pati një shkallë të përfshirjes prej 64.4% të fëmijëve në shërbimet e arsimit parashkollor në vitin 2019, Turqia 54.7%, Mali i Zi rreth 70%, Kroacia 77%, Sllovenia 90% e kështu me radhë. Maqedonia e Veriut bën përjashtim në këtë drejtim, me një shkallë të përfshirjes prej 36.9%, e ngjashme me Kosovën, për fëmijët e moshës tre vjeç e më lart.

5.3. Rëndësia e edukimit në fëmijërinë e hershme

Ekziston një marrëveshje e përgjithshme se ofrimi i arsimit cilësor në fëmijërinë e hershme është themel për arritjet kognitive (njohëse) dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Po ashtu ka shumë hulumtime që tregojnë rëndësinë shumë të madhe që ka edukimi parashkollor në zhvillimin e fëmijëve: (a) Programet parashkollore kanë ndikim pozitiv në arsimimin e hershëm, të mësuarit emocional shoqëror dhe suksesin akademik⁴⁴; (b) Nxënësit që e fillojnë shkollimin në kopsht të fëmijëve kanë më shumë gjasa të kenë rezultate të mira në aspektin akademik dhe shoqëror gjatë gjithë karrierës së tyre arsimore⁴⁵; (c) Fëmijët nga mosha tre deri në pesë vjeç janë në fazë jetike të zhvillimit akademik dhe shoqëror-emocional⁴⁶; (ç)

⁴¹ Nga intervistat në kopshtet e vizituara, nga rastet e hetuara dhe nga informatat e MASHTI-t.

⁴² https://www.oecd.org/els/soc/PF3_2_Enrolment_childcare_preschool.pdf

⁴³ European Commission (EC), «Key Data on Early Childhood Education and Care in Europe- Euridice Report», European Commission, Brussels, 2019.

⁴⁴ Barnett, Carolan, Fitzgerald, & Squires, 2012; Cunningham, 2010; Duncan & Magnuson, 2013; Invernizzi, Landrum, Teichman, & Townsend; Departamenti i Arsimit i SHBA, 2014).

⁴⁵ D. P.-S. E. M. U. t. L. E. o. P. a. T. P. o. P. Education, «Catrina Manigo, Rinyka Allison,» US Department of Education, Washington, D.C. , 2017.

⁴⁶ Ahmad, 2015; Burchinal et al., 2010; Cunningham, 2010; Dearing et al., 2009).

Aktivitetet që përfshihen në programet parashkollore janë parashikues të suksesit të ardhshëm në shkollë.⁴⁷

Rrjedhimisht, politikat adekuate, të përkthyer në praktika lejuese në institucionet arsimore, do të shërbenin për të realizuar potencialin e plotë njohës, funksional dhe shoqëror të fëmijës. Është e vetëkuptueshme se parakushti i parë për këtë është krijimi i mundësive për përfshirjen e fëmijëve në shërbimet e edukimit në fëmijërinë e hershme.

Të dhëna shumë interesante dhe të besueshme për rëndësinë e arsimit parashkollor në arritjet njohëse dhe sjelljen sociale të nxënësve mund të gjenden në projektin Arsimi Efektiv Parashkollor dhe Fillor 3-11 (AEPF 3-11)⁴⁸, një studim afatgjatë (1996-2003) që hulumtoi ndikimin e faktorëve në prapavijë, përvojave parashkollore dhe shkollore në një mostër kombëtare të fëmijëve të vegjël në Angli të moshës prej 3 deri në 11 vjeç.

Gjetjet kryesore të këtij hulumtimi të ndërlikuar, që janë të rëndësishme për arsimin parashkollor, janë: (a) Cilësia dhe efektiviteti i arsimit parashkollor mbeten në aspektin statistikor parashikues domethënës të arritjeve dhe rezultateve shoqërore/të sjelljes në vitin e 6-të dhe të progresit përgjatë fazës kryesore 2, pasi të jetë marrë parasysh ndikimi i faktorëve të mjedisit të përgjithshëm; (b) Nxënësit në pozitë më të pafavorshme (dhe ata me prindër më pak të kualifikuar) tregojnë arritje më të larta në vitin e 6-të, nëse më parë e kanë ndjekur ndonjë edukim parashkollor shumë cilësor ose shumë efektiv; (c) Ndjekja e një institucioni parashkollor në krahasim me mosndjekjen e tij (grupi i “shtëpisë”) ka një efekt pozitiv në rezultatet e mëvonshme të fëmijëve në lëndën e gjuhës angleze (ES=0.22), të matematikës (ES=0.26) dhe në sjellje “pro-shoqërore” (ES=0.19) në fund të vitit të 6-të; (ç) Megjithatë, më tej në raport, autorët e studimit për AEPF-në e theksojnë si një nga gjetjet kryesore të hulumtimit të tyre se “*Cilësia e edukimit parashkollor të ndjekur është e rëndësishme ku cilësia e lartë çon në një efekt më të madh dhe më të qëndrueshëm në rezultatet e arritjes si në anglisht ashtu edhe në matematikë (ES=0.29 & ES=0.34).*”⁴⁹

Në kontekstin e Kosovës, rezultatet e testit PISA për vitin 2015 kanë treguar se nuk ka ndonjë dallim në rezultatet e nxënësve mes fëmijëve që kanë ndjekur edukimin në fëmijërinë e hershme për dy vjet dhe atyre që nuk e kanë ndjekur atë. Në dritën e gjetjeve të hulumtimit të AEPF-së më lart del se edhe ajo shkalla e ulët (rreth 7%) e ofrimit të edukimit parashkollor në Kosovë nuk është relevante për zhvillimin e fëmijëve. PISA për Kosovën mund të shpjegohet me gjetjet e ngjashme të hulumtimit të AEPF-së për sa u përket fëmijëve që kishin ndjekur edukimin parashkollor me cilësi të ulët: “*Fëmijët që kishin vijuar arsimin parashkollor me cilësi të ulët nuk dolën më mirë në lëndën e matematikës dhe anglishtes se sa ata që nuk kishin vijuar arsimin parashkollor, ... ndërsa fëmijët që nuk kishin vijuar arsimin parashkollor vazhduan të kishin sjellje më të dobët pro-shoqërore krahasuar me ata që kishin shkuar në parashkollor.*” Kjo nënkupton që ofrimi i arsimit parashkollor me cilësi të ulët në Kosovë nuk kontribuon në zhvillimin dhe arritjet njohëse të fëmijës, por mund të ndihmojë në shoqërimin dhe sjelljen shoqërore të fëmijës.

⁴⁷ (Barnett, 2008; Weber-Stratton, Reid, & Stoolmiller, 2008).

⁴⁸ <https://ro.uow.edu.au/cgi/viewcontent.cgi?referer=&httpsredir=1&article=2684&context=sspapers#:~:text=Research%20Brief%3A%20Effective%20Pre%2DSchool,between%20the%20ages%20of%203.>

⁴⁹ P. Sammons, K. Silva, E. Melhuish dhe e. al, Effective pre-school and primary education 3-11 project (EPPE 3-11): influences on children's cognitive and social development in year 6, London: DCSF Publishing, 2008, pp. 1-6.

Cilësia ose mungesa e cilësisë së edukimit të ofruar në fëmijërinë e hershme ndikohet edhe nga mungesa e mekanizmave adekuatë për vlerësimin e hershëm shumëdisiplinor të nevojave njohëse, funksionale dhe shoqërore të fëmijës. Mungesa e këtyre mekanizmave ka implikime negative në diagnostikimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të mësuar. Po ashtu mungesa e planeve individuale të zhvillimit për fëmijët me nevoja të veçanta të moshës 3-5 vjeç është ngushtë e lidhur me mungesën e vlerësimit të hershëm. Asnjë nga kopshtet e vizituara nuk kishte mekanizëm për vlerësimin e hershëm të fëmijëve, duke thënë se atyre nuk u lejohet ta bëjnë këtë dhe nuk kanë ekspertizë për këtë. Në fakt, në Kosovë vlerësimi aplikohet vetëm për fëmijët në moshën 6 vjeç, në moshën për regjistrim në shkollat fillore.

Implikimet e thella dhe rëndësia e ofrimit të arsimit cilësor në fëmijërinë e hershme theksohen më tej në gjetjet e hulumtimit të AEPF-së se jo vetëm fëmijët që kishin vijuar arsimin jo cilësor, por edhe ata që vijnë arsimin parashkollor të cilësisë mesatare *“nuk tregojnë ndonjë përfitim të rëndësishëm njohës në arritshmëri [në shkrim-lexim] pas gjashtë viteve në shkollën fillore.”* Kjo do të thotë se nuk mjafton vetëm të sigurohet qasje në edukimin në fëmijërinë e hershme, por ai edukim duhet t'i plotësojë kërkesat dhe standardet e cilësisë së lartë.

5.4. Roli i institucioneve private në arsimin parashkollor

Vlen të theksohet se gjatë vitit shkollor 2021-2022 në arsimin parashkollor në institucionet private-kopshte janë përfshirë 5.374 fëmijë, krahasuar me 4.937 fëmijë që shërbehen nga institucionet publike (shih Shtojcën 3 të raportit). Të dhënat tregojnë se numri i fëmijëve në institucionet parashkollore private tejkalon atë të fëmijëve të përfshirë në institucionet publike. Rregullimi më i mirë dhe mbështetja e sistemit për këtë formë të ofrimit të Edukimit Fillor të Hershëm (EFH) mund të rezultojë në përmirësimin e përfshirjes së përgjithshme dhe edukimit në këtë nivel të arsimit. Pavarësisht kësaj numri i fëmijëve që marrin pjesë në një lloj EFH-je në institucione private mund të jetë më i madh se ai që është paraqitur më sipër, por nuk ka të dhëna të sakta dhe të besueshme për këtë sektor për këtë nivel të arsimit.

Një model të mirë ia vlen të përmendet është një nga shkollat që vizituara në Prizren⁵⁰ për hulumtimin tonë, në vitin 2022 hapi dy paralele parashkollore për fëmijët 3-5 vjeç. Tridhjetë e pesë fëmijë nga fshatrat përreth e kalonin kohën, mësonin dhe luanin së bashku për tri orë çdo ditë në kopshtin e improvizuar. Tridhjetë e katër fëmijë të tjerë (mosha > pesë) i vijonin klasat parafillore në të njëjtën shkollë. Shkolla po ashtu ofronte ushqime të lehta për ta gjatë qëndrimit të tyre në shkollë. Menaxhmenti na tha se kjo është arritur në bashkëpunim me komunitetin, komunën dhe organizatën Save the Children dhe pa punësim të stafit shtesë. Edukatorët që intervistuaam deklaruan se fëmijët ishin të lumtur që po mësonin dhe po përparonin mirë me bashkëmoshatarët e tyre. Fëmijët u panë aktivë dhe të angazhuar. Kishte një përshtypje bindëse se në grupet mësimore që vizituaam atë ditë fëmijët po shoqëroheshin dhe po mësonin. Save the Children siguroi mobile të përshtatshme, lodra të bollshme dhe materiale mësimore. Kjo duket të jetë një mënyrë shumë efektive dhe jo e shtrenjtë për të shtrirë edukimin në fëmijërinë e hershme edhe në zonat rurale. Me mbështetje të përqendruar, kjo shkollë mund të shërbejë si model i mirë për mobilizimin e të gjithë aktorëve të arsimit për rritjen e shërbimeve aq të nevojshme të edukimit në fëmijërinë e hershme në Kosovë.

5.5. Arsimi parafillore

⁵⁰ Në mbështetje Save the Children, në Prizren

LAPRK, në nenet 9 dhe 49 (dispozitat kalimtare), përcakton se arsimi parafillor do të trajtohet si arsim i detyrueshëm në Kosovë sapo të ketë fonde të mjaftueshme publike në dispozicion për të mbështetur përfshirjen e plotë në institucionet arsimore. Situata është dukshëm më e mirë kur shikohet përfshirja e fëmijëve të grup-moshës 5-6 vjeç në shkolla dhe kopshte, si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Në këtë grup-moshë u ofrohet arsim parafillor apo parashkollor mbi 22 mijë fëmijëve.

Megjithatë, edhe ky nivel i arsimit ka mangësi dhe pabarazi në ofrimin e arsimit. Ndonëse fëmijët e kësaj grup-moshe që ndjekin këtë formë të edukimit në shkollat publike kalojnë vetëm dy orë me edukatorët e tyre, me bashkëmoshatarët e tyre në shkollat private dhe në kopshtet publike përfitojnë nga shërbimet e plota të kujdesit ditor duke kaluar nga 4 deri në 8 orë me edukatorët e tyre. Kjo situatë në shkollat publike nuk është në përputhje me normat e kurrikulës kombëtare të Kosovës. Kurrikula Bërthamë për arsimin parafillor dhe fillor⁵¹ parashikon që fëmijët në klasat parafillore duhet të kalojnë të paktën 18 orë mësimore në javë në shkollë ose në institucion parashkollor. Praktikata aktuale mezi arrijnë 50% të kësaj kohe. Arsyeja për këtë, sipas drejtorëve komunalë të arsimit (DKA), të intervistuar për këtë studim, qëndron në mungesën e hapësirave shkollore në zonat urbane dhe në mungesën e stafit. Drejtorët e shkollave të vëzhguara pohuan se mungesa e hapësirave në zonat urbane e ka bërë të pamundur organizimin e më shumë orëve të kontaktit me nxënësit parafillorë. Megjithatë, vëzhgimet e ekipit hulumtues vërejtën të njëjtën situatë të qëndrimit dy orësh edhe në shkollat që vizitoi në zonat rurale, përfshirë ato që punojnë vetëm me një ndërrim. Duket se arsyetimi fillestar për mungesën e hapësirave është përhapur dhe është kthyer në një rutinë nëpër Kosovë, duke organizuar mësim më të shkurtër me fëmijët parashkollorë në shkollat publike.

Sa i përket pretendimit se ka mungesë të stafit, dihet se raporti nxënës-mësimdhënës në shkolla, në shumicën e komunave të Kosovës, është shumë nën normën ligjore prej 1 mësimdhënës për 21.4 nxënës në arsimin e përgjithshëm (dhe 18.6 nxënës në shkollat profesionale). Në fakt, raporti mesatar nxënës-mësimdhënës në nivel vendi për vitin shkollor 2020-2021 ka qenë mjaft i ulët me një mësimdhënës për 13.5 nxënës.⁵² Prandaj ky pretendim nuk përbën ndonjë argument të fortë. Një përjashtim të dukshëm nga kjo mund të jenë shkollat në disa nga qytetet më të mëdha të Kosovës, ku të dhënat e vëna në dispozicion nga MASHTI tregojnë se raporti nxënës-mësimdhënës sillet prej 18-21 nxënës për një mësimdhënës. I gjithë stafi i intervistuar parashkollor u ankua se trajtohen dhe paguhen me paga më të ulëta nga komunat si edukatorë (persona të kualifikuar për të punuar në institucionet parashkollore 0<5), edhe pse punojnë në shkollë, punojnë sipas kornizës së kurrikulës së shkollës fillore dhe në shumicën e rasteve kanë të njëjtat kualifikime si mësimdhënësit e tjerë që punojnë me nxënësit e shkollës fillore. Ata po ashtu theksuan dhe është vërejtur në shumë raste që ata u japin mësim dy grupeve të fëmijëve gjatë një dite shkollore - gjithsej 4 orë çdo ditë (të ngjashme me numrin e orëve të mësimin të mësimdhënësve të shkollave fillore).

Vlen të theksohet se pavarësisht kohës shumë të kufizuar në dispozicion, edukatorët parafillorë prapëseprapë punojnë për të arritur rezultatet e plota të mësimin dhe për të

⁵¹ MASHT, Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës, Prishtinë: MASHT, 2016, f. 95.

⁵² MASHTI, «Statistikat e Arsimit 2020-2021», MASHTI, Prishtinë 2021.

realizuar kurrikulat siç përshkruhet në Kurrikulën Bërthamë për arsimin parafillor dhe fillor.⁵³ Edukatorët e vëzhguar dhe të intervistuar ishin optimistë për arritjen e rezultateve të përcaktuara të mësimi, edhe pse vetëm një vlerësim më i detajuar mund të tregojë shkallën se sa janë të suksesshëm në këtë drejtim. Meqenëse klasa parafillore është pjesë e nivelit kurrikular 1 (klasat 0, 1 dhe 2), ka më shumë mundësi që shumica e rezultateve për këtë nivel të arrihen në klasat e mëvonshme (1 dhe 2) dhe kontributi i kësaj klase për atë qëllim është i kufizuar. Koha e humbur e nxënësve gjatë kësaj klase përgatitore, sipas të gjitha gjasave, kontribuon në ato 5.7 vite të kohës së humbur të nxënësve të Kosovës gjatë 13 viteve të arsimit parauniversitar (siç është konstatuar nga Indeksi i Zhvillimit Njerëzor për vitin 2018). Mësimi i humbur shkon në dëm të zhvillimit njohës dhe funksional të nxënësit, por edhe në dëm të aftësive dhe të sjelljes sociale.

5.6. Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen në arsimin e përgjithshëm parauniversitar

Më poshtë janë paraqitur dhe diskutuar shkurtimisht disa dimensionet e të drejtave të fëmijëve në arsim, siç janë: dhuna në shkollë, braktisja e shkollës, krimi kibernetik dhe keqpërdorimi i internetit, si dhe puna e fëmijëve, të cilët janë trajtuar si faktorë që ndikojnë në pjesëmarrjen në arsim. Këto dimensionet janë të rëndësishme, sepse, nëse neglizhohen, ato jo vetëm që ndikojnë negativisht në rezultatet e fëmijëve në shkolla, por gjithashtu përbejnë shkelje të të drejtave themelore të fëmijës, siç përmendet në legjislacionin në fuqi.

Dhuna në shkollë - Elementet që shkaktojnë dhunën në shkollë janë si brenda ashtu edhe jashtë kampuseve shkollore. Dhuna në shkollë është po ashtu pasqyrim i dhunës në familje, i bulizmit, i shpërndarjes së substancave dhe drogave të paligjshme, i pranisë dhe aktiviteteve të bizneseve abuzive në afërsi të shkollave, i qasjes së lehtë të qytetarëve në armë të ndryshme etj. Të gjitha këto shërbejnë në shtimin e dhunës në shkolla, e cila pastaj ndikon negativisht në rezultatin, në funksionimin dhe në menaxhimin e shkollës edhe më keq sesa që është. Për shembull, puna e rrezikshme e fëmijëve jo vetëm që ndikon në rezultatin e fëmijëve në shkollë dhe në zhvillimin e tyre (si pjesë e së drejtës për arsimim), por po ashtu i cenon të drejtat e tyre themelore të njeriut. Në Kosovë, sipas OECD-s, 32% e nxënësve raportuan se ishin ngacmuar të paktën disa herë në muaj, krahasuar me 23% sa është mesatarja në vendet e OECD-s. Në të njëjtën kohë, 83% e nxënësve në Kosovë (dhe mesatarisht 88% e nxënësve në vendet e OECD-s) u pajtuan ose u pajtuan fuqimisht se është gjë e mirë të ndihmohen nxënësit të cilët nuk mund ta mbrojnë veten.⁵⁴

Ekziston një politikë dhe kornizë ligjore koherente dhe sistematike në lidhje me dhunën në shkollë në Kosovë, e cila i ka edhe mekanizmat përkatës të zbatimit dhe monitorimit. Dhuna në shkollë adresohet në mënyrë adekuate në ligjet e arsimit, në kurrikulat kombëtare dhe në aktet nënligjore. Qeveria e Republikës së Kosovës e ka hartuar Rregulloren nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar⁵⁵, e cila përcakton kornizën konkrete institucionale dhe shumësektoriale për trajtimin e dukurisë së dhunës në institucionet arsimore në të gjitha nivelet e arsimit në

⁵³ MASHT, Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës, Prishtinë: MASHT, 2016, f. 95.

⁵⁴ OECD, «Kosovo - Country Report - PISA 2018 Results,» OECD, Paris, 2019.

⁵⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2013.; <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10292>

Kosovë. Rregullorja u detajua pastaj në udhëzues për zbatimin e tij⁵⁶ dhe në manualët didaktike që përcaktojnë masa dhe strategji konkrete për parandalimin, referimin dhe zbutjen e dhunës në shkolla. Janë mbajtur sesione të informimit dhe të trajnimit me autoritetet lokale, me drejtuesit e shkollave dhe me stafin në të gjitha komunat. Sesionet e informimit dhe të trajnimit përfshinin edhe demonstrimin e një moduli të veçantë, i cili u hartua dhe u aktivizua në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin (SMIA), që në mënyrë specifike shërben për referimin dhe raportimin e rasteve të dhunës në shkollë.

Vlen të theksohet se ka një mospërputhje ndërmjet numrit të rasteve të dhunës në shkollë të raportuara çdo vit nga shkollat në modulën SMIA dhe qindra rasteve që shkollat i kanë raportuar drejtpërdrejt në polici çdo vit. Kjo tregon për nevojën për adresimin urgjent të ndërhyrjes për parandalimin e dhunës në shkollë (policia mund të ndërhyjë më shpejt) dhe për mungesën e angazhimit të drejtuesve të shkollës për të regjistruar dhe referuar të gjitha rastet përmes sistemit SMIA. Gjatë hetimit për këtë raport, disa nxënës dhe prindër nga shkolla të ndryshme theksuan se dhuna fizike është e pranishme në shkollat e tyre. Megjithatë, duket se ka një pengesë për t'i bërë publike rastet e dhunës fizike dhe për t'i trajtuar ato në mënyrë aktive, shpesh me miratimin e heshtur të prindërve. Nxënësit dhe mirëqenia e tyre emocionale po e paguajnë çmimin e kësaj dukurie të vazhdueshme në disa shkolla të Kosovës për shkak të tolerancës nga stafi mësimdhënës dhe prindërit. Po ashtu është e vërtetë se shumica e prindërve dhe e nxënësve kanë deklaruar qartë se në shkollën e tyre nuk ka raste të dhunës fizike. Autoritetet duhet t'i ndërmarrin masat e nevojshme për zbutjen dhe adresimin e dhunës në shkolla në institucionet e tjera arsimore. Institucionet hulumtuese (si Instituti Pedagogjik i Kosovës) duhet ta hulumtojnë më tej këtë çështje dhe të dalin me rekomandime përkatëse.

Format e punës së rrezikshme - Puna e fëmijëve, në veçanti format e punës së rrezikshme dhe të vështirë, ndikojnë negativisht në mësimin dhe në zhvillimin e fëmijëve. Për ta rregulluar dhe përmirësuar gjendjen në aspektin e punës së fëmijëve, deri më tani Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, Udhëzimin Administrativ nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: Udhëzimi Administrativ nr.05/2013).⁵⁷ Raporti i Progresit i BE-së për Kosovën për vitin 2021 shkruan: *“Rreth 10% e fëmijëve në Kosovë janë të angazhuar në punë, prej të cilëve 6.8% punojnë në kushte të rrezikshme, dhe ky problem është veçanërisht evident tek komunitetet rom dhe ashkali.”*⁵⁸ Puna e fëmijëve nga radhët e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve është e lartë dhe është çështje shumë e ndërlikuar që ndërlikohet me sektorët e arsimit, të shëndetësisë, të mirëqenies sociale dhe të ekonomisë: *“Lypësia e fëmijëve dhe fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë, veçanërisht nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali, mbetet një problem të cilin autoritetet ende nuk e kanë trajtuar në mënyrë efektive. Martesa e hershme dhe e detyrueshme e fëmijëve, po ashtu mbetet shumë e përhapur tek këto komunitete.”*

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga MASHTI, kjo ministri është angazhuar në një numër aktivitetsesh, përfshirë: miratimin dhe shpërndarjen e manualeve didaktike në

⁵⁶ MASHT, «Doracak për zbatimin e Rregullores së QRK 21/2013 për Dhunën në Shkollë», MASHT, Prishtinë 2015.

⁵⁷ Udhëzimi Administrativ QRK nr. 05/2013 për parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë, është miratuar në mbledhjen e 137-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 02/137, më 3.7.2013.

⁵⁸ Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2021.

fushën e punës së fëmijëve; takimet informuese me palët e interesuara; punëtoritë me drejtoritë komunale të arsimit për Udhëzimin Administrativ nr. 05/2013; aktivitetet ndërgjegjësuese dhe ligjëratat informuese në shkolla.

Puna e rrezikshme e fëmijëve mbetet preokupim për autoritetet e arsimit dhe të mirëqenies sociale në Kosovë, veçanërisht për fëmijët e familjeve më të varfra dhe për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (intervistë). Problemi manifestohet në mënyrë më të theksuar në edukimin e fëmijëve adoleshentë, të cilët, si pasojë e punës së fëmijëve, mungojnë në shkollë, madje edhe e braktisin shkollimin në arsimin e mesëm të lartë.

Braktisja e shkollës - Të dhënat e SMIA-s tregojnë se aktualisht ka një shkallë të braktisjes së shkollës në Kosovë prej 0.05%, e cila ka shënuar një rënie të vazhdueshme në dy vitet e fundit (0.07 në vitin 2020 dhe 0.09% në vitin 2019). Megjithatë, ky nivel relativisht i ulët i braktisjes së shkollës e fsheh një problem më të madh të sistemit arsimor të Kosovës në lidhje me përfshirjen e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e detyrueshëm në Kosovë.

MASHTI ka miratuar Udhëzimin Administrativ 08/2018 për ngritjen dhe fuqizimin e ekipeve për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar.⁵⁹ Është hartuar dhe shpërndarë një doracak për ekipet e shkollave dhe për komunat kundër braktisjes së shkollës, i cili përmban instrumente, procedura dhe protokolle të qarta për identifikimin dhe raportimin e rasteve. Më tej MASHTI ka hartuar dhe zbatuar modulën për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm në kuadër të SMIA-s, i cili ka shërbyer për rritjen e efikasitetit të përpjekjeve për parandalimin e braktisjes së shkollës.

Janë organizuar aktivitete konkrete për t'i informuar dhe trajnuar autoritetet lokale dhe stafin e shkollës për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës si dhe për uljen e mosregjistrimit në shkollë. Së bashku me Komizën Monitoruese është zhvilluar një Plan Dyvjeçar i Veprimit për t'i mbështetur dhe ndërtuar kapacitetet e mekanizmave të parandalimit dhe reagimit në shkolla; inspektorëve dhe autoriteteve lokale për t'i zbatuar më mirë politikën e miratuara.

Gjatë vitit 2021, IAP ka publikuar raportin me rekomandime në lidhje me mungesën e harmonizimit të Ligjit nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (LAPRK) me Ligjin për Kundërvajtje⁶⁰. Avokati i Popullit vëren se Ligji për Kundërvajtje përcakton se askush nuk mund të dënohet për kundërvajtje për veprën e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar si kundërvajtje me ligj ose me akte (rregullore komunale) të kuvendit të komunës dhe *për të cilën nuk ka qenë i përcaktuar sanksioni kundërvajtës*. Për më tepër, Ligji për Kundërvajtje obligon që dispozitat për kundërvajtje që nuk janë në pajtim me të, përfshirë këtu edhe dispozitat përkatëse të LAPRK, të harmonizohen brenda afatit prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit për Kundërvajtje. Për më tepër Avokati i Popullit vlerëson se LAPRK-ja, përkatësisht neni 15- Vijueshmëria në shkollë; dhe neni 47- Shkollimi në shtëpi, nuk janë në harmoni me dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje, pasi nuk janë

⁵⁹ MASHTI, «Udhëzimi Administrativ 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënave në arsimin parauniversitar», MASHTI, Prishtinë 2018.

⁶⁰ Për më shumë detaje shih, Raport me Rekomandim *Ex-officio* nr. 69/2021 në lidhje me mungesën e harmonizimit të Ligjit nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, 2021, në: <https://oik-rks.org/raportet/ex-officio-raportet/> [e qasur së fundmi me datën 03.01.2021]

rregulluar me sanksione të qarta kundërvajtjese dhe si të tilla nuk kanë gjetur zbatim në asnjë rast.

Krimi kibernetik dhe keqpërdorimi i internetit- MASHTI ka hartuar dhe miratuar Udhëzim Administrativ (01/2019) për mbrojtjen e fëmijëve/nxënësve në internet, në Institucionet Arsimit Parauniversitar⁶¹, që synon ta mundësojë përdorimin e sigurt të internetit nga fëmijët, në përputhje me moshën dhe nevojat e tyre të zhvillimit social, emocional dhe njohës. MASHTI po ashtu përpiloi dhe shpërndau udhëzime për nxënësit, për mësimdhënësit dhe për prindërit (“Udhëtim përmes internetit”), të cilat paraqesin strategjitë dhe mënyrat e përdorimit të sigurt dhe të përgjegjshëm të internetit nga nxënësit dhe për mbrojtjen e tyre nga krimi kibernetik.

6. PËRFSHIRJA NË ARSIMIN E PËRGJITHSHËM PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË

6.1. Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara

Në këtë pjesë vlerësohet gjithë përfshirja e sistemit arsimor në Kosovë duke analizuar ofrimin e arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për fëmijët e komuniteteve të cenueshme jo shumicë në Kosovë. Në këtë pikë vlen ta kujtojmë dispozitën kushtetuese përkatëse: *“Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”* Apo siç do të shpjegohet më poshtë: A ofron sistemi arsimor një ndjenjë përkatësie, pranimi dhe njohjeje të dikujt që është ndryshe

Përfshirja sociale nënkupton një shoqëri ku të gjithë janë të përfshirë dhe ndihen të vlerësuar pavarësisht nga dallimet e tyre. Rrjedhimisht, përfshirja sociale identifikohet me “ndjenjen e përkatësisë, pranimit dhe njohjes së diversitetit të dikujt”.⁶² Nga ana tjetër, arsimi gjithëpërfshirës konsiderohet një mekanizëm për zgjerimin dhe promovimin e përfshirjes sociale.⁶³ Ky seksion i raportit e vlerëson nivelin në të cilin nxënësit me aftësi të kufizuara ndihen të pranuar dhe se janë të respektuar nga komuniteti i shkollës.

Neni 40 i LAPRK-së parashihet: *“Qëllimi i qartë i këtij Ligji është që parimi i arsimit gjithëpërfshirës të zbatohet në Kosovës si praktika më e mirë në përputhje me normat ndërkombëtare(…)”* Në përputhje me këtë dispozitë, Kosova ka aplikuar qasjen e integruar në edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, ku klasat e bashkëngjitura janë mbyllur gradualisht për t’i integruar ata në klasa të rregullta. Në të njëjtën kohë, procesi i shndërrimit të shkollave speciale në qendra burimore ka vazhduar të ofrojë mbështetjen e nevojshme për shkollat dhe për nxënësit me nevoja të veçanta.

Literatura ofron një gamë të gjerë interpretimesh dhe praktikash në lidhje me konceptin e nevojave të veçanta arsimore pasi “ajo nënkupton gjëra të ndryshme në vende të ndryshme”. Në Kosovë, neni 39 i LAPRK-së promovon kuptimin më të ngushtë që u referohet personave me nevoja të veçanta mësimore (të përcaktuara si vështirësi në të mësuar) dhe nxënësve që kanë prirje dhe që janë të talentuar. Në këtë Raport, përveç rasteve kur ceket në mënyrë specifike, ne u referohemi nxënësve me aftësi të kufizuara për të nënkuptuar edhe nxënësit me vështirësi për të mësuar, siç parashihet në nenin 39 të LAPRK-së dhe në dispozitat e

⁶¹ MASHTI, Udhëzim Administrativ (01/2019) për mbrojtjen e fëmijëve/nxënësve në internet, në Institucionet Arsimit Parauniversitar, MASHTI, Prishtinë 2019.

⁶² Cappo, 2002, siç citohet në Destani et al., 2015.

⁶³ D. K. Lipsky dhe A. Gartner, «Inclusive education: a requirement of a democratic society,» në World Yearbook of Education 1999, Inclusive Education, 2013.

LMF-së. LMF-ja në nenin 46, paragrafi 3, përcakton: “Fëmija me aftësi të kufizuara gëzon të drejtën për të përfitur nga shërbimet shëndetësore, sociale, edukative, si dhe çdo shërbim tjetër, sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.” Kjo dispozitë e ligjit përcakton qartë nevojën për një qasje shumësektoriale dhe shumëdisiplinore në adresimin e nevojave zhvillimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara në atë që kërkon ofrimin jo vetëm të arsimit, por edhe të shërbimeve shëndetësore dhe rehabilituese për fëmijët. Kjo është theksuar në mënyrë të përsëritur nga të gjithë edukatorët dhe zyrtarët e intervistuar në institucionet dhe në autoritetet arsimore. Osc, siç thotë një edukator që punon me një nxënës: “[Nxënësi im] sapo u kthye nga një periudhë tri javore e rehabilitimit. Fatkeqësisht, nuk shoh ndonjë përmirësim; duket se kemi humbur pjesën më të madhe të progresit të bërë gjatë pjesës së parë të vitit shkollor. Nuk jam i sigurt se fëmija është dërguar në shërbime të rehabilitimit. Është shumë e rëndësishme që të paktën në shkollat tona (qendrat burimore) të vihen në dispozicion shërbimet e rehabilitimit. Nuk jam i sigurt se çfarë bëjnë ata kur unë nuk jam me nxënësin tim.”

Legjislacioni dhe politikat e Kosovës qartazi e promovojnë përfshirjen. Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2023) bazohet në disa objektiva strategjike, ndër të cilat Objektivi Strategjik 3 parashikon: Krijimi i kushteve për gjithëpërfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën kohë, neni 5, paragrafi 1, nënparagrafi 12, i LAPRK-së vë theksin në ofrimin e politikave për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta. Nenet 39 dhe 40 të LAPRK-së po ashtu promovojnë mbështetjen e këtij grupi të fëmijëve në fushën e arsimit. KKK-ja e adreson arsimin gjithëpërfshirës si një nga parimet kryesore.⁶⁴

Përveç kësaj, ekzistojnë edhe disa faktorë të tjerë që kanë ndikim në promovimin e gjithëpërfshirjes në arsim në Kosovë, përfshirë edhe cilësinë e mësimdhënies, ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe të organeve kompetente, ndërgjegjësimin për rëndësinë e përfshirjes, trajnimin e profesionistëve kompetentë (mësimdhënësve, ndihmësve, mësimdhënësve mbështetës). Një buxhet i planifikuar mirë mund të sjellë progres në përmirësimin e përfshirjes. Buxheti i miratuar për vitin 2022 tregon për një qasje dhe rëndësi të fokusimit në mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Kosova e ka krijuar konceptin dhe strukturën e saj kryesore të arsimit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Koncepti kryesor është ai i një qasjeje të integruar, ku fëmijët që nuk kanë dëmtime të rënda vendosen dhe integrohen në klasa të rregullta me nxënës të rregullt. Me ndihmën e UNICEF-it, Kosova ka vënë në përdorim edhe një platformë online për fëmijët me aftësi të kufizuara, e cila përfshin materiale mësimore, metoda të mësimdhënies, materiale për mësimdhënësit dhe udhëzime për prindërit. Mësimdhënësit e klasës ndihmohen nga mësimdhënësit ndihmës dhe nga mësimdhënësit mbështetës të nevojave të veçanta arsimore të vendosur në shkollat më të mëdha të Kosovës.

Në të njëjtën kohë, fëmijët me dëmtime të rënda vendosen dhe shkollohen sipas planeve të individualizuara të edukimit në një nga shtatë qendrat burimore në Kosovë⁶⁵, secila e

⁶⁴ MASHt, Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, MASHt 2016.

⁶⁵ Gjatë vitit 2021, përfaqësuesit e IAP-së vizituan Qendrën Ditore të Fëmijëve në Prishtinë; Qendrën Burimore “Përparimi” në Prishtinë; Qendrën e Kujdesit Ditor “PEMA” në Prishtinë; Qendrën Burimore “Nëna Terezë” për mësim dhe këshillim për nxënësit me dëmtime në dëgjim e të folur në Prizren; Qendrën Burimore “Lef Nosi” për mësim dhe këshillim për nxënësit me dëmtime intelektuale në Prizren; Qendrën Burimore “Nënë

specializuar për një grup të aftësive të kufizuara. Qendrat burimore shërbejnë edhe si qendra burimore dhe të trajnimit për mësime të rregullta. Përveç kësaj, qendrat burimore kanë edhe mësime të shëtitës, që mbështesin mësuesit në shkollat e rregullta për të ofruar shërbime për nxënësit e tyre. Zakonisht ata u ndihmojnë mësuesve në përgatitjen e planeve individuale të edukimit dhe të arsimit dhe mbështesin/monitorojnë zbatimin e tyre me nxënës individualë.

Për këtë raport është vizituar një qendër burimore për ta vlerësuar rolin dhe kontributin e tyre në edukimin për nxënësit me nevoja të veçanta. Vlen të theksohet se kjo qendër është e pajisur mirë, e menaxhuar mirë dhe shumë e dobishme për nxënësit që përfitojnë nga shërbimet e saj. Mësuesit janë shumë të përkushtuar, kreativë dhe shumë kompetentë. Në fakt, personeli i qendrës dukej se ishte i gatshëm për një rol më të rëndësishëm në fushën e edukimit të nxënësve me nevoja të veçanta. Ata hartonin materialet e tyre mësimore në bazë të nevojave dhe interesave të nxënësve, hartonin dhe zbatonin plane të detajuara arsimore individuale për çdo nxënësi; ata dukeshin të gatshëm dhe kompetentë për të ofruar trajnime për mësuesit në shkollat e rregullta në strategjitë për të mësuar dhe për të mundësuar mësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe të atyre me vështirësi në të mësuar. Gjatë intervistave dhe diskutimeve, personeli bëri thirrje për një koordinim më sistematik të përpjekjeve rehabilituese dhe arsimore, përkatësisht për bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet ekspertëve të sektorit të arsimit dhe të shëndetësisë. Ata gjithashtu konsideruan se ka hapësirë për më shumë bashkëpunim ndërmjet qendrave burimore dhe shkollave të rregullta, duke përfshirë edhe të tjerë, përveç mësuesve të shëtitës për nevojat e veçanta arsimore (të siguruar nga qendrat) për të përfshirë njohjen e hershme të aftësive të kufizuara, zhvillimin e materialeve mësimore, trajnimin e personelit të shkollave, hartimin dhe rishikimin e kurrikulave, hartimin e planeve mësimore individuale për nxënësit me vështirësi në të mësuar. Personeli i qendrës burimore ka ofruar argumente të forta për fuqizimin e tyre dhe për rritjen e mbështetjes për ndikim më të madh të këtyre qendrave në fushën e arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta në Kosovë.

6.2. Pjesëmarrja në arsim e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë ende duke përjetuar vështirësi serioze dhe përballen me pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj. Fëmijët me aftësi të kufizuara i përkasin njërës prej grupeve më të rrezikuara të fëmijëve. Situata e tyre është përkeqësuar edhe më tepër nga pandemia.⁶⁶ Viti 2022 nga Qeveria e Republikës së Kosovës është shpallur si "Viti i personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës". Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës (nr. 8/46), i datës 30 nëntor 2021, në mbështetje të nenit 92 të Kushtetutës, paraqet kalendarin e aktiviteteve të aprovuara, të cilat fokusohen në ofrimin e mundësive për të gjithë.⁶⁷

Një raport i projektit "Rrjeti Kosovar për Arsim dhe Punësim - KEEN", i financuar nga BE-ja, tregon për pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të veçanta arsimore gjatë viteve 2015-2020 në klasat e rregullta dhe në qendrat burimore (ish-shkollat

Tereza" për mësim dhe këshillim për nxënësit me dëmtime intelektuale në Mitrovicë; Qendrën Burimore "Xheladin Deda" për mësim dhe këshillim për nxënësit e verbër dhe me shikim të dobësuar, në Pejë.

⁶⁶ IAP: Raporti Vjetor 2021, fq.56.

⁶⁷ Republika e Kosovës, «Vendimi Nr. 08/46», Prishtinë 2021.

speciale).⁶⁸ Statistikat e pjesëmarrjes së nxënësve me aftësi të kufizuara për vitet 2015/16; 2016/17⁶⁹ dhe 2017/18; 2018/19; 2019/20⁷⁰, shih në Shtojcën 4 të raportit. Mund të shohim se mes viteve 2015/16 dhe 2016/17 ka pasur një rënie prej 9.8% të fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në sistemin arsimor. Ky dallim bëhet edhe më i madh në rreth 30% mes viteve 2016 dhe 2020. Kjo paraqet dilema rreth funksionimit të sistemit, por edhe rreth sistemit të grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave.⁷¹

Megjithatë, viteve të fundit (2019, 2020 dhe 2021) ka një rritje të lehtë të përfshirjes së fëmijëve në klasa të rregullta dhe një rënie e numrit të tyre në qendrat burimore.⁷² Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion nga MASHTI⁷³ për vitin 2021, 4016 nxënës kanë qenë të përfshirë në institucionet arsimore (përfshirë fëmijët e moshës 0-5 vjeç në klasat parashkollore dhe parafilllore), gjë që konfirmon trendin e rritjes së përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkollimin e rregullt. Në anën tjetër, numri i fëmijëve në shkollat speciale/qendrat burimore vazhdoi të ulej në 307 në vitin 2021⁷⁴ dhe pastaj në 291 në vitin 2022.⁷⁵ Kjo mund të shpjegohet me vështirësitë e shkaktuara nga mungesa e shpeshtë e shërbimeve të transportit dhe izolimi i shkaktuar nga pandemia COVID-19, por mund të paraqesë edhe një reagim më të madh në ofrimin të arsimit të rregullt për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë.

Nga ana tjetër, një studim i UNICEF-it vlerëson se në Kosovë janë 43.000 nxënës⁷⁶ me nevoja të veçanta, ndërsa vetëm rreth 5.000 janë të përfshirë në arsimin institucional i ofruar në shkollat e rregullta. Nga ana tjetër, nëse mbështetemi në Qarkoren Buxhetore 2022 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), rezulton se në Kosovë janë 17.794 persona me nevoja të veçanta.⁷⁷ Kjo shifër mund t'u referohet personave që përfitojnë nga skemat e ndihmës sociale. Në këtë raport ne u referohemi burimeve zyrtare. Sidoqoftë, është e qartë se ka një përfshirje të ulët, ndonëse Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (PSAK) parasheh që deri në fund të vitit 2021, 50% e fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshihen në sistemin arsimor.⁷⁸ Raporti i UNICEF-it, i bazuar në statistikën e MASHTI-t, identifikon 5.294 nxënës me aftësi të kufizuara të certifikuar (41% femra dhe 59% meshkuj), që është larg synimit i përcaktuar në PSAK-u për përfshirjen e 50% të fëmijëve.

6.3. Çështjet kryesore në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta

⁶⁸ D. e. a. Pupovci, «Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë në vitin 2017- Raport vlerësimi», BE&KEEN, Prishtinë 2017.

⁶⁹ D. e. a. Pupovci, «Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë në vitin 2017- Raport vlerësimi», BE&KEEN, Prishtinë 2017.

⁷⁰ K. Bajrami, «Vlerësimi i Realizimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021», EU&KEC, Prishtinë 2021.

⁷¹ D. e. a. Pupovci, «Zbatimi i Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë në vitin 2017- Raport vlerësimi», BE&KEEN, Prishtinë 2017.

⁷² K. Bajrami, «Vlerësimi i Realizimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021», EU&KEC, Prishtinë 2021.

⁷³ Në janar 2022, IAP-ja iu drejtua MASHTI-t duke kërkuar të dhëna të ndryshme statistikore (për financimin e sistemit arsimor, pjesëmarrjen në të gjitha nivelet e arsimit, pikët në testet e maturës etj.) dhe ata u përgjigjën me shkrim gjatë të njëjtit muaj.

⁷⁴ MASHTI, «Statistikat e Arsimit 2020-2021», MASHTI, Prishtinë 2021.

⁷⁵ MASHTI, «Shënime statistikore 2021/2022», MASHTI, Prishtinë 2021.

⁷⁶ UNICEF, «Perception of accessible and inclusive education for children with special needs», Prishtinë 2019.

⁷⁷ MFPT, «Qarkorja buxhetore 2022», Prishtinë 2021.

⁷⁸ MASHTI, «Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021», MASHTI, Prishtinë 2016.

Fëmijët me aftësi të kufizuara i përkasin një prej grupeve më të rrezikuara të fëmijëve. Situata e tyre është përkeqësuar edhe më tepër nga pandemia. Në Raportin e veçantë lidhur me emergjencën shëndetësore, IAP ka konstatuar se lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara në nivel vendi nuk ka pasur një strategji gjithëpërfshirëse mbështetëse për ta dhe në shumë raste mbështetja dhe ndihma ka qenë e përkohshme, e keq organizuar dhe nuk ka mbuluar të gjithë fëmijët në të njëjtën kohë⁷⁹. IAP i ka rekomanduar Qeverisë që të hartojë dhe të zbatojë një plan gjithëpërfshirës të përkrahjes së fëmijëve në përgjithësi, e të atyre me aftësi të kufizuara në veçanti, për shërbimet shëndetësore të garantuara me ligj, duke u fokusuar edhe në programet e rehabilitimit, të terapive psiko-sociale, të imunizimit, të ushqyeshmërisë cilësore, të ndihmës ndaj prindërve si dhe MASHT që të rrit numrin e asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara, gjithnjë duke u bazuar në kërkesat e komunave⁸⁰.

Arsyet kryesore për nivelin e ulët të pjesëmarrjes del se janë (i) niveli i vetëdijesimit/qëndrimit shoqëror ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe (ii) kapaciteti i kufizuara i sistemit për të ofruar shërbime arsimore dhe rehabilituese për personat me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë. Pengesat e tjera janë mungesa e fondeve, e ekspertizës dhe e shërbimeve të specializuara mbështetëse. Kështu, sipas pjesëmarrësve në një hulumtim të UNICEF-it⁸¹, kërkesat kryesore për institucionet e Kosovës janë: sigurimi i asistentëve personalë në shkolla, sigurimi i kurrikulave për fëmijët me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, sigurimi i pajisjeve lehtësuese për fëmijët me aftësi të kufizuara/nevoja të veçanta, sigurimi i transportit për në shkollë dhe ofrimi i fizioterapisë. Personeli i shkollës dhe prindërit e intervistuar theksuan nevojën për të përmirësuar ofrimin dhe koordinimin e shërbimeve të rehabilitimit.

Situata joadekuate me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor kërkon një rritje të numrit të asistentëve në shkolla. Rrjedhimisht, siç shihet edhe më lart, kërkesa e parë dhe më e shpeshtë e institucioneve të Kosovës është sigurimi i asistentëve personalë për mësimdhënësit nëpër shkolla. Sipas realizimit të PSAK 2017-2021⁸², mungesa e asistentëve është një nga sfidat më të mëdha. Në Kosovë janë 52 mësimdhënës mbështetës dhe 86 asistentë, që punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta dhe kjo nuk i plotëson nevojat e shkollave. Buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i miratuar për vitin 2022, parashikon punësimin e 100 asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta. Buxheti i qeverisë i ndarë për pagimin e asistentëve është 0.78 milion euro.⁸³ Kjo e plotëson një nga kërkesat (të parën) sipas hulumtimit të UNICEF-it.

Megjithatë, hetimi ka gjetur se asistentët për nxënësit me nevoja të veçanta dhe mësimdhënësit mbështetës duhet të përdoren me kujdes të madh dhe planifikim më të mirë. Shpesh ndodh në shkolla që të kenë asistentë për fëmijët me aftësi të kufizuara, që sigurohen privatisht nga prindërit. Vëzhgimet në klasë, intervistat me drejtorët e shkollave dhe diskutimet në fokus-grupe kanë treguar se angazhimi i tyre me fëmijët përkatës me aftësi të kufizuara në shumicën e rasteve funksionon kundër integritit të këtyre nxënësve në

⁷⁹ Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, fq. 146.

⁸⁰ Po aty, fq. 162-163.

⁸¹ UNICEF, «Perception of accessible and inclusive education for children with special needs», Prishtina 2019.

⁸² K. Bajrami, «Vlerësimi i Realizimit të Planit Strategjik për Arsimin në Kosovë 2017-2021», EU&KEC, Prishtinë 2021.

⁸³ MFPT, Qarkorja buxhetore 2022, Prishtinë 2021, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/F5FEB244-0870-43DC-B8C2-CED67056926D.pdf>

shkollimin e rregullt. Vëmendja e veçantë që ata u kushtojnë nxënësve individualë vetëm sa e ndan atë nxënës nga pjesa tjetër e klasës. Në të njëjtën kohë, ata nuk duket se e zbatojnë gjithmonë të njëjtën kurrikulë, përmbajtje mësimore dhe rezultatet si mësimdhënësi i klasës dhe si pjesa tjetër e klasës. Si i tillë, angazhimi i një asistenti për një nxënës nuk duket si mekanizëm për përfshirje apo për integrim. Ngjashëm me asistentët për fëmijët me aftësi të kufizuara, asistentët e edukimit special, të ofruar me buxhetin e Kosovës, nuk duket se kanë arritur ta luanin rolin që do ta maksimizonte ndikimin e angazhimit të tyre. Domethënë, ata kanë nevojë për më shumë fuqizim dhe mbështetje nga autoritetet komunale dhe nga drejtuesit e shkollave për të ofruar më shumë mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta.

Lidhur me aspektin e sigurimit të kurrikulave për fëmijët me nevoja të veçanta, disa autorë⁸⁴ konfirmuan efikasitetin e ulët të arsimit special në Kosovë. Shkak për një situatë të tillë ndër të tjera është edhe mungesa e një kurrikule sistematike për këtë grup fëmijësh. Neni 39, paragrafi 4, i LAPRK-së thekson mundësinë e modifikimit të kurrikulës për fëmijët me nevoja të veçanta ose me dhunti të veçantë.

Shtrohet pyetja: A ka një kurrikulë sistematike që trajton punën me fëmijët me nevoja të veçanta? Sot nuk ka rezultate që tregojnë për ndonjë kurrikulë të hartuar për fëmijët me nevoja të veçanta. Megjithatë, aktet nënligjore të MASHTI-t parashikojnë plane arsimore individuale për fëmijët me nevoja të veçanta, si një dokument zyrtar për planifikimin e procesit mësimor të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe për mbështetjen dhe përparimin e këtyre fëmijëve.⁸⁵ Sipas Udhëzimit Administrativ 18/2013 për Përdorimin e Planit Individual Arsimor (Udhëzimi 18/2013)⁸⁶, neni 2, paragrafi 3, përcakton: "*Plani Individual Arsimor shërben për planifikimin sistematik të edukimit dhe arsimit, mësimdhënies dhe mësimnxënies, për mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit individual të fëmijës.*" Për përdorimin e Planit Individual të Arsimit (PIA), vendimi merret nga ekipi vlerësues dhe mbështetës i komunës, sipas nenit 3, paragrafi 1, të këtij udhëzimi. PIA-s hartohet në bazë të udhëzuesit përkatës të miratuar nga MASHT-i, sipas nenit 4, paragrafi 1, të Udhëzimit 18/2013. Më pas, neni 4, paragrafi 2, i Udhëzimit 18/2013 përcakton: "*PIA duhet të hartohet përmes një procesi bashkëpunues, duke përfshirë shkollën, prindin, fëmijën kur është e përshtatshme dhe personelin tjetër përkatës.*" Po ashtu, PIA-s, sipas nenit 6, paragrafi 1, të Udhëzimit 18/2013 rishikohet dhe vlerësohet dy herë gjatë vitit dhe, në rast të kalimit të fazës tranzitore të personave që punojnë me fëmijën.⁸⁷ Dy çështje kryesore dalin në pah gjatë analizimit të dispozitave të Udhëzimit 18/2013, pasi ai nënkupton: (i) Nevojat e veçanta të të nxënës nga fëmija tashmë janë identifikuar dhe janë të njohura për ekipin vlerësues dhe mbështetës të komunës; dhe (ii) Vlerësimi dhe hartimi i planit individual të arsimit nuk bëhet më herët se për fëmijët mbi pesë vjeç (pas aplikimit për regjistrim në arsimin parafillor dhe fillor).

6.4. Njohja e hershme e aftësisë së kufizuar

Vlerësimi i aftësive të kufizuara dhe i vështirësive në të nxënë në moshën pesë ose gjashtë vjeç është tepër vonë për njohjen e hershme dhe për ofrimin e mbështetjes adekuate për nevojat e veçanta arsimore të fëmijës. Referimi i hershëm dhe qasja shumëdisiplinore janë të rëndësishme: "*Planifikimi dhe përfshirja e gjerë e komunitetit është thelbësore për të*

⁸⁴ Landsman & Berdyna (2009).

⁸⁵ MEST, Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe Udhëzuesi për Hartimin e Planit Individual të Arsimit për Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore, Prishtinë, Save the Children, 2017.

⁸⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10137>

⁸⁷ Udhëzimi 18/2013, neni 6, paragrafi 2.

mundësuar kuptimin dhe pranimin e objektivave shëndetësore dhe zhvillimore. Veçanërisht në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme kërkohet një qasje që do të siguronte ndërtimin e kapaciteteve vendore për të ardhmen në mënyrë që të mundësohet krahasimi më i gjerë i objektivave shëndetësorë, arsimorë dhe socialë.”⁸⁸

I njëjti artikull thekson se identifikimi i hershëm mund të jetë një komponent i mundshëm dhe efektiv për të mbështetur fëmijët dhe familjet e tyre, edhe kur shërbimet ose pajisjet e specializuara të trajtimit nuk janë aq lehtë në dispozicion, siç është rasti me Kosovën. Shërbimet e njohjes dhe ndërhyrjes së hershme mund të rezultojnë në terapi specifike motorike, të të folurit ose të tjera, që mund ta përmirësojnë cilësinë e jetës dhe ta përmirësojnë zhvillimin e ardhshëm njohës, motorik dhe social për një fëmijë me vonesë ose me aftësi të kufizuara neuro-zhvillimore.

Hulumtimet e përgjithshme flasin në favor të njohjes dhe ndërhyrjes së hershme. Ndërhyrja para kopshtit sjell përfitime të mëdha akademike, shoqërore dhe ekonomike. Vonesat në zhvillim, çrregullimet në të nxënë dhe problemet e sjelljes dhe ato shoqërore-emocionale vlerësohet se prekin 1 në çdo 6 fëmijë.⁸⁹ Studimet kanë treguar se fëmijët që marrin trajtim të hershëm për vonesat në zhvillim kanë më shumë gjasa ta përfundojnë shkollën e mesme, t'i mbajnë vendet e punës, të jetojnë të pavarur dhe ta shmangin shtatzëninë e adoleshentëve, delikuecën dhe krimin e dhunshëm, duke rezultuar në një kursim të madh për shoqërinë.⁹⁰ Një studim gjithëpërfshirës i Korporatës RAND tregoi se programet e planifikuara mirë për fëmijët në pozitë të pafavorshme të moshës 4 vjeç e më lart mund të sjellin përfitime ekonomike që sillen nga 1.26 dollar deri në 17 dollarë për çdo 1 dollar të shpenzuar në programe.⁹¹ Përveç kësaj, studimi gjeti se programet me cilësi të lartë për fëmijërinë e hershme mund t'i mbajnë fëmijët jashtë programeve të shtrenjta të edukimit dhe të arsimit special.⁹²

Hetimi në terren për këtë raport ka treguar se shpesh ka rezistencë tek prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë për të bërë vlerësimin dhe për të hartuar PIA-n për fëmijët e tyre.⁹³ Nga 56 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë në një nga shkollat e vizituara, vetëm një nxënës i ishte bërë vlerësimi dhe kishte një PIA-s. Sipas një mësuesi për nxënësit me nevoja të veçanta: *“Prindërit hezitojnë të na lejojnë të përpilojmë një PIA për fëmijët e tyre duke këmbëngulur që fëmija i tyre duhet të integrohet plotësisht me fëmijët e tjerë, duke rezistuar që fëmija të “etiketohet” si fëmijë me aftësi të kufizuara. Kjo ndodh edhe në rastet kur fëmijët diagnostikohen me aftësi të kufizuara nga ekspertët mjekësorë.”* Ky hezitim që fëmijët të vlerësohen dhe që të përpilohen PIA-t ishte i pranishëm në të gjitha shkollat e vizituara. Mësimdhënësit e shkollave, të ndihmuar nga mësimdhënësit për fëmijët me nevoja të veçanta dhe psikologët e shkollës, ende u kushtojnë

⁸⁸ M. C. S. K. a. E. S. ALFRED L. SCHERZER, Global perspective on early diagnosis and intervention for children with developmental delays and disabilities, Published online: Author manuscript, 2012.

⁸⁹ B. Zablotzky, L. Black, M. M. L. Schieve, M. Danielson, R. Bitsko dhe C. ... & Boyle, «Prevalence and trends of developmental disabilities among children in the United States: 2009–2017.» *Pediatrics*, Vëllimi 144(4):e20190811, 2019.

⁹⁰ F. Glascoe, «Early detection of developmental and behavioral problems.» *Pediatrics in Review*, Vëllimi 21, nr. 8, p. 272–280, 2000.

⁹¹ J. Heckman, M. S., R. Pinto, P. Savelyev dhe A. & Yavitz, «The rate of return to the High/Scope Perry Preschool Program.» *Journal of Public Economics*, Vëllimi 94, nr. 1-2, p. 114–128., 2010.

⁹² L. A. Karoly, M. R. Kilburn dhe J. S. Cannon, «Early Childhood Interventions: Proven Results, Future Promise.» Rand Corporation, Santa Monica, CA, 2005.

⁹³ Në korrik 2018, Avokati i Popullit hapi hetimet Ex-officio nr. 449/2018 lidhur me çështjen e përfshirjes në sistemin arsimor të nxënësve me aftësi të kufizuara.

vëmendje të veçantë këtyre nxënësve, por mosbashkëpunimi i prindërve pengon ndjeshëm përpjekjet për t'i adresuar në mënyrën më të duhur nevojat e nxënësve për mësim dhe zhvillim. Një qasje e tillë e prindërve, sipas mësimdhënësve të intervistuar dhe drejtorëve të shkollave të vizituara, ndikon negativisht edhe në përpjekjet e bashkërenduara për rehabilitimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë, pasi prindërit kanë një rol qendror në bashkërendimin e përpjekjeve për të nxënë dhe rehabilitimin e fëmijëve. Një mësimdhënëse në një qendër burimore u ankua se të gjitha përpjekjet e saj gjatë dy muajve të fundit kishin shkuar dëm pasi prindi nuk e kishte dërguar nxënësin në rehabilitim gjatë pushimit shkollor: *“Siç mund ta shihni, ajo është shumë e trazuar dhe e shqetësuar. Prindi i saj na premtoi se do ta dërgonte në rehabilitim gjatë pushimit, por nuk e bëri. Tani kanë humbur dy muaj. Nuk e di nga t'ia filloj dhe çfarë do të bëj tani.”*

6.5. Personeli mësimdhënës

Disa autorë⁹⁴ e kanë ndërlidhur përmirësimin e efikasitetit të arsimit special me trajnimin e mësimdhënësve për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta. Gjithashtu literatura tregon se mënyra më e mirë për ta aplikuar arsimin gjithëpërfshirës është që mësimdhënësit t'i identifikojnë dhe t'i njohin nevojat e veçanta të të gjithë fëmijëve, të kenë njohuri për përdorimin e udhëzimeve mbi punën me fëmijët me nevoja të veçanta dhe t'i kenë aftësitë e duhura për të punuar në një mjedis gjithëpërfshirës.⁹⁵

Nga ana tjetër, sipas MASHTI-t: *“Trajnimi i drejtorëve dhe mësimdhënësve të arsimit të mesëm të lartë është parashikuar për përmirësimin e qasjes dhe edukimit dhe arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta dhe shumë e shumë aktivitete të tjera.”* Gjithashtu, sipas MASHTI-t dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, çdo vit do të rritet numri i asistentëve të punësuar për punë me fëmijët me nevoja të veçanta.⁹⁶ Të gjitha këto masa janë më se të nevojshme, pasi vizitat në shkolla kanë treguar se mësimdhënësve u mungon informacioni dhe trajnimi për t'u përballur në mënyrën më të mirë me nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë. Të gjithë mësimdhënësit e intervistuar u ankuan se integrimi i nxënësve me aftësi të kufizuara është realizuar pa ua ofruar mbështetjen e duhur mësimdhënësve dhe shkollave për integrimin e tyre të plotë. Ata shtuan se është e vështirë të punosh me një numër të madh nxënësish dhe të fokusohesh në nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Nga informacionet e mësipërme vërehet rëndësia e përgatitjes së mësimdhënësve për punë përkatëse me fëmijët me nevoja të veçanta. Pra, Fakulteti i Edukimit, si fakultet për mësimdhënie, ofron rreth pesë lëndë në kuadër të programeve të veta, që kanë në fokus përfshirjen, të drejtat e fëmijëve dhe nevojat e veçanta. Po ashtu, në nivelin Master ofrohet një program i veçantë për përgatitjen e mësimdhënësve për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta.⁹⁷ Udhëzimi Administrativ nr. 26/2012 Kualifikimet e Personelit që Punon me Nxënës me Nevoja të Veçanta Arsimore rregullon kualifikimet e personelit mësimor që punon me nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta⁹⁸, kurse Udhëzimi

⁹⁴ Landsman dhe Maloku-Berdyna (2009).

⁹⁵ G. Hornby, *Inclusive Special Education: Evidence based practices for children with special needs and disabilities*, Springer, 2016.

⁹⁶ A. Nagavci, Punësimi i asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta, 2021.

⁹⁷ Universiteti i Prishtinës, «Programet», 2021. [Online]. Gjenden: <https://edukimi.uni-pr.edu/page.aspx?id=13>.

⁹⁸ MASHT, Udhëzimi Administrativ Nr. 26/2012 Kualifikimet e Personelit që Punon me Nxënës me Nevoja të Veçanta Arsimore, Prishtinë, MASHT, 2012.

Administrativ nr. 12/2012 Kriteret për Zgjedhjen e Asistentëve dhe Instruktorëve për Arsim Gjithpërfshirës dhe Obligimet e Tyre përcakton kriteret për punën si asistent dhe si instruktor për fëmijët me nevoja të veçanta.⁹⁹ Kërkon që një person t'i ketë kryer studimet Bachelor për edukim ose ta ketë shkollën e mesme me trajnime shtesë në fushën e arsimit për të punuar me nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Kjo dispozitë ka shërbyer mjaft mirë për punësimin e atyre që më vonë morën pjesë në kursin për asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta, i organizuar nga "Lux Development".

Gjatë periudhës së COVID-19, fëmijët me nevoja të veçanta nuk u përfshinë si duhet në mësimin online. Kjo fillimisht ndodhi për shkak se MASHTI siguroi një platformë online për ta vetëm në fund të muajit prill.¹⁰⁰ Sipas deklaratave të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe aktivistëve për të drejtat e fëmijëve me nevoja të veçanta, këta fëmijë nuk mund t'i bashkoheshin mësimin/ortëve mësimore online. Kështu deklaruan edhe prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta. Kjo situatë i demotivoi fëmijët me nevoja të veçanta nga vazhdimi i të mësuarit në klasë.¹⁰¹ Megjithatë, burime të tjera, siç janë zyrtarët e intervistuar të MASHTI-t dhe të dhënat nga përdorimi i platformës, treguan se ajo ishte përdorur gjerësisht nga prindërit gjatë dhe pas periudhës COVID-19.

6.6. Mjedisi mësimor

Për sa u përket kushteve të punës dhe mjedisit mësimor për fëmijët me nevoja të veçanta, disa autorë kanë pohuar se¹⁰² qysh nga viti 2000 shkollat speciale janë transformuar në qendra burimore.¹⁰³ Huluntimi i tyre tregon po ashtu rezervat që kanë mësimdhënësit e shkollave fillore në klasa/shkolla të rregullta për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta, duke pasur parasysh se mjedisi i përshtatshëm për këtë grup fëmijësh ofrohet në shkollat speciale. Kjo do të thotë se qendrat burimore të dedikuara për fëmijët me nevoja të veçanta supozohet të kenë mjedis të dedikuar për këtë aspekt. Hetimi në terren për këtë raport ka hasur në raste që tregonin për një qasje më të rezervuar në shkolla ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta. Për shembull, në një fokus-grup me prindër mësuam se një nxënës me nevoja të veçanta nuk ishte mirëpritur nga prindërit në tri klasa (me miratim diskret nga kujdestari i klasës); vetëm mësimdhënësi, nxënësit dhe prindërit e klasës së katërt ishin pajtuar që ta kenë një shok të ri klase me aftësi të kufizuara - me nevoja të veçanta arsimore. Megjithatë, ka pasur shumë më tepër raste gjatë hetimit që flisnin në favor të një qasjeje më gjithëpërfshirëse, ku komuniteti i shkollës ofronte një mjedis miqësor për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Shumica e meritave u takojnë kryesisht nxënësve, por edhe mësimdhënësit të cilët po bëjnë më të mirën (në mungesë të trajnimit dhe mbështetjes teknike) për t'i integruar fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me nevoja të veçanta arsimore. Mbi pesëdhjetë nxënës (përfshirë nxënës me nevoja të veçanta) dhe dhjetëra mësimdhënësit pjesëmarrës në diskutimet e fokus-grupeve deklaruan se fëmijët me aftësi të kufizuara mirëpritën nga nxënësit në shkolla. Katër nxënës me aftësi të kufizuara na thanë se ishin pritur dhe mbështetur ngrohtësisht nga shokët e klasës. Ata gjithashtu shtuan se nuk kishin dëgjuar për raste kur nxënësit me aftësi të kufizuara ishin bulizuar ose refuzuar nga nxënësit.

⁹⁹ MASHT, Udhëzimi Administrativ 12/2012 Kriteret për Zgjedhjen e Asistentëve dhe Instruktorëve për Arsim Gjithpërfshirës dhe Detyrimet e Tyre, Prishtinë 2012.

¹⁰⁰ OShC, «Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2020», Prishtina 2021.

¹⁰¹ A. K. Selani, «Radio Evropa e Lirë», 14 tetor 2020. [Online]. Gjetet: <https://www.evropaelire.org/a/femije-me-nevoja-te-vecanta-shkollimi-30892924.html>.

¹⁰² Zabeli, Perolli-Shehu & Anderson (2021).

¹⁰³ Në fakt, ky proces filloi të zbatohet disa vite më vonë.

6.7. Çështje për diskutim të mëtejshëm

Bazuar në literaturën në dispozicion dhe në të dhënat për gjendjen aktuale të përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta, vërehet se politikat arsimore nuk zbatohen mjaftueshëm në Kosovë. Kjo kryesisht i referohet nivelit të ulët të pjesëmarrjes në sistemin arsimor të fëmijëve me nevoja të veçanta. Megjithatë, hetimi tregon një nivel të kënaqshëm të përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara, të cilët janë të integruar në shkollimin e rregullt, pavarësisht mangësive dhe vështirësive të përmendura në fillim të këtij seksioni.

Sfidë konsiderohet edhe mungesa e të dhënave të sakta për fëmijët me nevoja të veçanta në popullatë dhe brenda sistemit arsimor, duke e vështirësuar planifikimin e shërbimeve nga DKA-të dhe nga vetë shkollat. Shkollat nga ana e tyre kanë kapacitete shumë të kufizuara për ta promovuar përfshirjen.

Për të arritur rezultate në zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive të fëmijëve me nevoja të veçanta në lidhje me kërkesat e planit arsimor individual, duhet të kemi mësimdhënës të përgatitur për të punuar me këta fëmijë. Është vërejtur se mësimdhënësit në shkollat e rregullta kanë kualifikim mësimor, por jo domosdo edhe trajnim adekuat për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta dhe kjo e vështirëson punën në arritjen e rezultateve të duhura. Nga ana tjetër, janë rritur mundësitë për zhvillim dhe trajnim të asistentëve në bazë të mundësive të trajnimit që i ofron programi njëvjeçar për asistentët mësimdhënës që ofron "DevLux". Gjithashtu, sipas udhëzuesit për qasjen dhe ofrimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta për vitin shkollor 2020-2021, qendrat burimore duhet të bashkëpunojnë vazhdimisht me shkollat e rregullta, me mësimdhënësit, me asistentët dhe me prindërit duke ofruar mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta.¹⁰⁴

Rrjedhimisht vërejmë se për të krijuar një mjedis dhe kushte për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë, krahas buxhetit, duhet të ofrohet edhe më shumë trajnim për mësimdhënësit për të punuar me nxënësit me aftësi të kufizuara, pasi kualifikimi që ata marrin në studimet para shërbimit nuk konsiderohen të mjaftueshme. Mësimdhënësit e intervistuar deklaruan se janë të gatshëm për të ofruar një mbështetje më të mirë për nxënësit me aftësi të kufizuara, por kanë nevojë për trajnim dhe mbështetje më të mirë për atë qëllim.

Burimet e nevojshme duhet të ndahen brenda vetë shkollave. Hartimi i një kurrikule specifike për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta do ta përmirësonte qasjen e të gjithë aktorëve brenda shkollave të rregullta, duke rritur motivimin e mësimdhënësve që jo vetëm ta synonin zbatimin e politikave, por edhe ta promovonin një kulturë gjithëpërfshirëse duke krijuar një qasje dhe mjedis përkatës për fëmijët me nevoja të veçanta, ku do të ndiheshin të pranuar dhe të zhvilloheshin krahas nxënësve të tjerë.

6.8. Edukimi dhe arsimit i fëmijëve të komuniteteve të cenueshme joshumicë

Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës (PSAK) 2017-2021 e analizon përfshirjen dhe pjesëmarrjen e ulët në arsim të fëmijëve nga grupet margjinale si një sfidë madhore e sistemit arsimor në Kosovë, duke deklaruar se fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë kanë një shkallë jashtëzakonisht të ulët të pjesëmarrjes në arsimin parashkollor dhe në të mesëm të lartë, ndërsa shkalla e përgjithshme e regjistrimeve në arsimin e detyrueshëm (klasat 1-9) është

¹⁰⁴ MASHT, «Udhëzues për qasjen dhe ofrimin e mbështetjes për nxënësit me nevoja të veçanta për vitin shkollor 2020-2021», Prishtina 2020.

rreth 85%, që është ende nën mesataren kombëtare. PSAK-u po ashtu përcakton një rezultat të pritshëm (1.4) që thekson: *“Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor është rritur për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë është rritur për 20%.”* dhe një varg masash konkrete (1.4.1-1.4.5) që do ta përmirësonin ofrimin dhe regjistrimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve në të gjitha nivelet e arsimit.

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare 2017-2021¹⁰⁵ konsiderohet si një dokument i rëndësishëm në përvijimin e veprimeve të qeverisë për përmirësimin e gjendjes së këtyre komuniteteve në shoqërinë kosovare. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën konstaton se kjo Strategji është zbatuar vetëm pjesërisht dhe i bën thirrje qeverisë të përshpejtojë përgatitjet për hartimin dhe miratimin e një plani të ri strategjik. Ngjashëm me këtë, Vlerësimi i Zbatimit të PSAK-ut 2017-2021 i Qendrës për Arsim të Kosovës¹⁰⁶ tregon se ka pasur zbatim të pamjaftueshëm të të gjithë treguesve që kanë të bëjnë me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (shih në Shtojcën 5 të raportit - Niveli i zbatimit të treguesve në lidhje me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në PSAK 2017-2021).

Për shumicën e treguesve, situata në fund të periudhës së PSAK-ut (2021), në vend se të përmirësohej siç ishte paraparë, është më e keqe se në fillim të zbatimit të tij në vitin 2017. Për ilustrim, përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian në arsimin parafillor në vitin 2017 ishte 53.9%, viti i parë i zbatimit të PSAK-ut. Objektivi i vendosur për PSAK-un ishte rritja e përfshirjes në 70% deri në vitin 2021. Në vend të kësaj, ndoshta edhe për shkak të pandemisë, shkalla e përfshirjes ra me nëntë pikë të përqindjes në 44.9%. Ngjashëm ka ndodhur edhe në arsimin fillor (një rënie prej 1.2%) dhe në arsimin e mesëm të ulët (me 1.3%). Vetëm shkalla e përfshirjes dhe e kalimit në arsimin e mesëm të lartë ka ngecur në të njëjtin nivel si në vitin 2017, që nuk është një arritje duke pasur parasysh se shteti ka investuar për pesë vjet për ta përmirësuar situatën e përfshirjes në arsimin e mesëm të lartë. Kjo situatë mund të shpjegohet për shkak të shpërthimit të pandemisë COVID-19 pasi, siç është diskutuar në këtë raport, grupeve të cënueshme u mungonte teknologjia dhe nuk kishin kushte për të mësuar në shtëpi gjatë izolimit të shkaktuar nga pandemia. E njëjta gjë konfirmohet edhe nga Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2021, ku thuhet: *“Vlerësohet se gjithsej 9,070 (ose 2,8%) fëmijë nuk janë përfshirë në mësimin në distancë të organizuar gjatë pandemisë në pertudhën mars-qershor 2020, për shkak të mungesës së qasjes në mjete dhe pajisje mësimore.”* Është e sigurt të supozohet se mbi 50% e këtyre nxënësve janë fëmijë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Pavarësisht nga arsyet e moszbatimit, vlen të theksohet se autoritetet kosovare të arsimit do të duhej ta mobilizoheshin dhe t'i jepnin prioritet arsimimit të këtyre komuniteteve para se pasojat të bëheshin të pariparueshme.

6.9. Masat afirmative

Legjislacioni që rregullon sistemin arsimor në Kosovë është plotësisht në përputhje me dispozitën afirmative kushtetuese mbi nevojën e krijimit dhe mundësimin të një mjedisi për zhvillimin e potencialit të plotë të nxënësve në përputhje me nevojat e tyre specifike. Kështu, sistemi arsimor në Kosovë ofron një sërë masash afirmative që përpriqen ta përmirësojnë të

¹⁰⁵ Zyra e Kryeministrit - Zyra për Qeverisje të Mirë, «Strategjia për Përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021», Qeveria e Kosovës, Prishtinë 2017.

¹⁰⁶ K. Bajrami, «Vlerësimi i Zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021», Qendra për Arsim e Kosovës - QAIN Project, Prishtinë 2021.

nxënit dhe zhvillimin njohës të nxënësve të komuniteteve joshumicë. Siç mund të shihet në tabelën e mëposhtme, për komunitetet joshumicë lejohen më shumë mësimdhënës, më shumë fonde, klasa më të vogla dhe shkolla më të vogla në krahasim me komunitetin shumicë shqiptar (shih në Shtojcën 6 të raportit - Masat afirmative në nivel të sistemit për komunitetet joshumicë në arsimin e Kosovës).

Vlen të theksohet se gjendja në lidhje me këto kritere ka ndryshuar përgjatë viteve për komunitetin shumicë. Gjegjësisht statistikat janë ulur ndjeshëm për shkak të trendeve demografike dhe arsyeve të tjera. Për shembull, raporti nxënës-mësimdhënës në Kosovë ka rënë në 12.5 nxënës për mësimdhënës në vitin 2021, gjë që bën që të mos zbatohet më masa afirmative prej 14.1 nxënës për një mësimdhënës për nxënësit e komuniteteve. Në fakt zbatimi i këtij kriteri do të nënkuptonte diskriminim të nxënësve të komuniteteve në krahasim me nxënësit shumicë. Prandaj është shumë me rëndësi që MASHTI t'i rishikojë dispozitat ligjore përkatëse dhe formulën e financimit të arsimit parauniversitar.

Ka masa të tjera konkrete për ta mbështetur arsimin e komuniteteve më të cenueshme. Disa komuna japin bursa për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë që vijnë nga kategoritë e familjeve që marrin ndihmë sociale dhe për nxënësit pa prindër. MASHTI së bashku me partnerët, si: Fondi për Arsimimin e Romëve (REF), VORAE – HEJS, e më herët KFOS-i, përmes projektit EUSIMRAES2 shpërndanë materiale mësimore, bursa, mjete mbështetëse për mësim dhe shërbime të tjera për ta përmirësuar shkollimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Zakonisht çdo vit shpërndahen rreth 500-600 bursa për nxënësit e shkollave të mesme, pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

6.10. Pjesëmarrja në arsim e nxënësve joshumicë

Këto masa afirmative gjithsesi kanë ndihmuar në përmirësimin e kushteve të mësimin dhe në rezultatet e nxënësve të komuniteteve joshumicë. Kjo vlen veçanërisht për nxënësit e komuniteteve boshnjak dhe turk, të cilët, pavarësisht vështirësive të zakonshme për tërë sistemin arsimor në Kosovë, janë plotësisht të integruar dhe përfitojnë nga një gamë e plotë e shërbimeve arsimore në Kosovë. Një çështje që duket se është vërejtur gjatë fazave dhe metodave të ndryshme të këtij hetimi (analizës së dokumenteve, intervistave dhe fokus-grupeve) ishte mungesa e teksteve shkollore për mësim në gjuhën turke dhe në atë boshnjake. Prindërit, nxënësit, mësimdhënësit, përfaqësuesit e komunitetit, aktivistët e OJQ-ve, madje edhe autorët e teksteve shkollore, anëtarë të këtyre komuniteteve, vazhdimisht thoshin: *“Edhe 20 vjet pas luftës nuk ka tekste shkollore për fëmijët e tyre!”* Natyra e vazhdueshme e këtij problemi dhe rëndësia e teksteve shkollore në arsimin e Kosovës tregojnë se ka diskriminim në arsim ndaj këtyre komuniteteve. Shkaqet e këtij diskriminimi duket se janë neglizhenca dhe mungesa e përkushtimit nga ana e autoriteteve kosovare të arsimit dhe e shtëpive botuese në Kosovë. Neni 27 i LAPRK-së parasheh: *“Tekstet në gjuhët e komuniteteve në të cilat është duke u zhvilluar mësimi në nivelet 1 dhe 2 ofrohen pa pagesë.”* Mungesa e teksteve mësimore në gjuhën boshnjake dhe në atë turke është shkelje e drejtpërdrejtë e dispozitave të këtij ligji. Neni 8 i të njëjtit ligj parasheh që inspektorati i arsimit duhet ta sigurojë zbatimin e dispozitave që rregullojnë përdorimin e teksteve shkollore. Duhet të bëhen hulumtime të mëtejshme për ta vlerësuar përgjigjen e autoriteteve të arsimit në këtë drejtim. Statistikat e arsimit tregojnë për një përfshirje të qëndrueshme të nxënësve nga këto komunitete në të gjitha nivelet e arsimit (shih në Shtojcën 7 të raportit - Regjistrimi në arsimin parauniversitar sipas përkatësisë etnike).

Statistikat e mësipërme vënë në pah disa probleme kryesore lidhur me përfshirjen e nxënësve të komuniteteve joshumicë në arsimin e Kosovës: (a) Të dhënat për pjesëtarët e komunitetit serb kryesisht mungojnë, me përjashtim të komunës së Kamenicës. Shkollat me mësim në gjuhën serbe refuzojnë të integrohen në arsimin e Kosovës dhe vazhdojnë të punojnë sipas planeve dhe programeve të Republikës së Serbisë në të cilën janë të përfshirë edhe një numër i nxënësve të komunitetit jo shumicë¹⁰⁷; (b) Nxënësit goranë janë të integruar mirë në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët me një tendencë të vazhdueshme të përfshirjes nga një nivel në tjetrin; (c) Nxënësit e komuniteteve boshnjak dhe turk kanë një shkallë të qëndrueshme të pjesëmarrjes, me rreth 200-250 nxënës në arsimin parauniversitar gjatë një viti shkollor. Këto shifra janë më të ulëta në arsimin e mesëm të lartë krahasuar me arsimin e detyrueshëm; (ç) Nxënësit nga komuniteti joshumicë pothuajse nuk janë të përfshirë fare në edukimin në fëmijërinë e hershme, ku vetëm 0.1% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve e ndjekin këtë nivel edukativo-arsimor. Kjo bëhet edhe më shqetësuese kur kemi parasysh se përfshirja e nxënësve të komunitetit shumicë shqiptar në këtë nivel arsimor është me mbi 7 pikë të përqindjes së popullsisë së përgjithshme të kësaj grup-moshe; (d) Numri i nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian shënon një rënie të ndjeshme me rastin e kalimit nga shkolla e mesme e ulët në atë të mesme të lartë.

Sa i përket rënies së numrit të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, statistikat e MASHTI-t tregojnë se në Kosovë ka mesatarisht rreth 400 nxënës ashkalinj në çdo klasë të arsimit fillor (klasat 1-9), por kjo shifër bie në më pak se 80 nxënës për një klasë të arsimit të mesëm të lartë (10-12). Ngjashëm, në një komunë që është përfshirë në këtë hulumtim, janë gjithsej 195 nxënës ashkalinj në arsimin parauniversitar (klasat 1-12) ose mesatarisht rreth 33 nxënës për klasë. Megjithatë, vetëm 37 prej tyre ndjekin klasat e arsimit të mesëm të lartë (10-12) ose 12 nxënës për klasë, që është për dy të tretat më e ulët sesa mesatarja për klasat 1-12.

Informata shumë të dobishme për pjesëmarrjen në arsim të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian jepen nga Raporti i Gjetjeve të Anketës së Grupimeve me Tregues të Shumëfishtë (MICS) nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-i¹⁰⁸ për vitet 2019-2020. Kjo Anketë tregon progresin e bërë në edukimin dhe në arsimimin e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në nivel të shkollës fillore (duke arritur pjesëmarrje prej 85.3%), por gjithashtu tregon për një rënie drastike të pjesëmarrjes dhe shkallës së përfundimit të arsimit, fillimisht në arsimin e mesëm të ulët (rreth 59%), e më vonë edhe rënie të mëtejshme të pjesëmarrjes dhe përfundimit të arsimit të mesëm të lartë (në 24%). Autoritetet kosovare të arsimit dhe aktivistët e arsimit duhet të angazhohen në mënyrë më aktive në identifikimin e arsyeve për shkallën e braktisjes së shkollës së mesme nga pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Shifrat për shkallën e kalimit (fazës kalimtare) nga shkolla fillore në atë të mesme të ulët dhe pastaj në shkollën e mesme të lartë janë më të ulëta për vajzat sesa për djemtë, gjë që nënkupton pasoja të rënda në jetën dhe karrierën e popullatës së gjinisë femërore të këtyre komuniteteve në Kosovë.

Kërkohet një analizë më e thellë për të përcaktuar arsyet prapa këtyre të dhënave statistikore. Një vështrim më nga afër i të dhënave të siguruar nga MASHTI-SMIA për trendet e pjesëmarrjes së nxënësve nga këto komunitete sipas klasave tregon se shkalla e regjistrimit fillon të bjerë me shpejtësi (deri në 50%) që në klasën e nëntë (të arsimit të mesëm të ulët)

¹⁰⁷ IAP, rasti nr.48/2022.

¹⁰⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-i, «Anketa e Grupimeve me Tregues të Shumëfishtë 2019-2020, Kosova dhe Komunitetet RAE MICS 2019-2020», KAS dhe UNICEF-i, Prishtinë 2020.

dhe kjo pjesëmarrje më e ulët konsolidohet në klasat dhjetë deri në dymbëdhjetë. Një supozim bazë do të mundë të ishte se kjo është koha kur ata fillojnë ta braktisin shkollën për të punuar dhe për t'i ndihmuar familjet e tyre t'i përballojnë nevojat e tyre. Sipas zyrtarëve të intervistuar të MASHTI-t, rastet e raportuara në SMIA tregojnë se fëmijët e braktisin shkollën për shkak të varfërisë dhe të problemeve të mirëqenies (përfshirë neglizhencën nga ana e prindërve), që më së shpeshti rezultojnë në angazhimin e tyre në ndonjë formë të rëndë dhe të rrezikshme të punës së fëmijëve. Aktivistët e intervistuar të komuniteteve na thanë se faktori i dytë më i rëndësishëm pas punës është braktisja e shkollave nga vajzat pas klasës së nëntë. Kjo është një prej arsyeve kryesore të pjesëmarrjes më të ulët në arsim të këtyre komuniteteve. Duke u gjendur në një situatë të rëndë ekonomike, familjet mund të vendosin t'i mbajnë vajzat në shtëpi dhe që djemtë ta ndjekin shkollimin. Kjo gjithashtu mund të ndërlihdet edhe me martesat e hershme, që janë të pranishme te këto komunitete.

Të dhënat e vëna në dispozicion nga MASHTI vetëm konfirmojnë trendin e lartcekur, pasi anëtarët e këtyre tri komuniteteve përbëjnë rreth 50% të atyre që e braktisin shkollën para kohës. Ky informacion nuk do të ishte arsye për alarm nëse këto komunitete nuk do të përbënin më pak se 3% të popullsisë në Kosovë. Gjegjësisht, nga 67 nxënës që kanë braktisur shkollimin gjatë viteve 2020-2021 në shkollat e Kosovës, në 30 raste të braktisjes së shkollës kjo ishte bërë nga pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Edhe pse arsimit i mesëm i lartë nuk është nivel i detyrueshëm i arsimit në Kosovë, është e qartë se ka probleme që duhet të adresohen për ofrimin e arsimit për pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Një qasje thjesht edukativo-arsimore nuk do të mundë të ishte efektive, sepse shkaqet e mospjesëmarrjes së tyre kryesisht kanë të bëjnë me aspekte jashtë arsimit. Nevojiten hulumtime të tjera mbi shkaqet e vërteta, në mënyrë që të gjenden zgjidhjet më të mira për të ofruar një perspektivë më të mirë në jetë për këta fëmijë dhe për familjet e tyre.

Një tregues tjetër i rëndësishëm në lidhje me pjesëmarrjen e këtyre komuniteteve në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është lloji i shkollave që mund të ndjekin. Gjatë hulumtimit në terren në dy gjimnaze, kur u pyetën për nxënësit nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, mësimdhënësit dhe nxënësit u përgjigjën se zakonisht nuk ka nxënës të këtyre komuniteteve në gjimnaze dhe se ata duhen kërkuar në shkollat profesionale. Hetimi që pasoi konstatoi gjetjet e mëhershme se, si rregull, këta nxënës nuk mund t'i plotësojnë kriteret më të rrepta (kriteret e notave) për t'u regjistruar në gjimnaz. Të njëjtën gjë e kanë konfirmuar edhe nxënësit e shkollave të mesme, të cilët janë intervistuar - pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe në të gjitha shkollat profesionale ku vijonin mësimin, të cilët theksuan se nuk mund ta plotësonin kushtin e notave për t'u regjistruar në gjimnaz dhe se *u ishte thënë* nga drejtuesit e shkollave profesionale se ata mund ta ndiqnin shkollimin vetëm në profilin e inxhinierisë së makinerive, edhe pse fillimisht kishin aplikuar për profile të tjera. Të pyetur se çfarë planifikonin të bënin pas shkollës së mesme të lartë, ata nuk mund të tregonin qartë për ndonjë profesion specifik të ardhshëm ose për ndonjë program studimesh universitare, pjesërisht për shkak se nuk po ndiqnin shkollat/profilet që kishin zgjedhur vet. Ky aspekt i shkollimit të tyre ka të bëjë edhe me masat afirmative e po ashtu edhe me rezultatin e nxënësve në shkolla. Autoritetet e arsimit duhet ta trajtojnë seriozisht jo vetëm pjesëmarrjen në arsim, por edhe rezultatin e tyre dhe rëndësinë e një arsimiti të tillë për zhvillimin e tyre.

6.11. Qendrat mësimore

Një element i rëndësishëm në arsimimin e nxënësve - pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, janë qendrat mësimore të rregulluara me Udhëzimin Administrativ 19/2018 për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave Mësimore. Roli i qendrave mësimore është të ofrojnë shërbime arsimore shtesë për të gjithë nxënësit që kanë nevojë për një mbështetje të tillë. Më së shpeshti qendrat mësimore në Kosovë krijohen dhe shërbejnë për të mbështetur fëmijët romë, ashkalinj dhe egjiptianë në zonat ku ata veprojnë, me qëllim të përfshirjes së tyre në arsim, përmirësimin e rezultateve së tyre në shkolla dhe lehtësimin e lëvizshmërinë sociale dhe integrimin në shoqëri. Qysh prej themelimit të tyre për herë të parë, qendrat mësimore funksionuan kryesisht përmes mbështetjes së donatorëve ndërkombëtarë. Në rastin më të mirë, qendrat mësimore janë dëshmuar të jenë shumë të dobishme në ofrimin e shërbimeve shtesë për fëmijët e këtyre komuniteteve, gjë që ka shërbyer pastaj në uljen e shkallës së braktisjes, përmirësimin e pjesëmarrjes së tyre në shkollim dhe rritjen e zhvillimit të tyre njohës dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare.

Sipas raporteve të Qendrës për Arsimit të Kosovës (KEC¹⁰⁹), rreth 83 qendra mësimore kanë funksionuar me bazë në komunitet dhe me bazë në shkollë në 20 komuna të Kosovës. Në vitin 2021 MASHTI vendosi t'i përfshijë ato në financim nga buxheti i shtetit, duke ua shtuar qëndrueshmërinë dhe duke ua bërë më të lehtë funksionimin. Viti i parë i një financimi të tillë, sipas stafit të intervistuar të qendrave mësimore, u karakterizua me më shumë siguri, por edhe me mungesë të pjesshme të fondeve, për shkak të sasisë së ulët të fondeve të caktuara për qendrat mësimore nga MASHTI (100.000 euro për vitin e parë). Të intervistuarit deklaruan se pjesa e fondit që kishin marrë u mjaftonte për tre muaj të funksionimit të tyre.

6.12. Pjesëmarrja e komuniteteve joshumicë në arsim

Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre janë të garantuara edhe me Kushtetutë e cila e ndalon diskriminimin e këtij komuniteti edhe në sektorin e arsimit. Kjo çështje është trajtuar si gjatë hetimit të dokumentacionit të çështjes, ashtu edhe gjatë intervistat e realizuara nga këto komunitete. Bazuar në gjetjet e hetimit, mund të konstatohet se, ndonëse ka raste të izoluara të diskriminimit, nuk mund të flitet për diskriminim të qëllimshëm, të organizuar dhe sistematik në nivel institucional. Më së shpeshti kundër pjesëtarëve të komunitetit rom ashkali dhe egjiptian. Sipas nxënësve, këto raste kryesisht kanë të bëjnë me mundësitë e regjistrimit, notimin dhe adresimin e incidenteve mes nxënësve të komuniteteve të ndryshme. Duket se kemi të bëjmë me neglizhencë dhe mungesë të vetëdijesimit nga ana e një numri edukatorësh, zyrtarësh të arsimit dhe drejtuesish të shkollave. Kjo u dëshmuar nga aktivistët e intervistuar të komunitetit në më shumë se një rast, kur për shembull konfliktet mes nxënësve nuk ishin marrë seriozisht nga mësimdhënësit, prindërit dhe drejtorja e shkollës. Drejtuesit e shkollës luajnë një rol të rëndësishëm në këtë drejtim. Sipas aktivistëve të komuniteteve dhe nxënësve, rastet e incidenteve janë më të shpeshta në shkollat me drejtorë dhe menaxherë më të dobët.

Gjatë hetimit u bë krahasimi mes dy shkollave në të njëjtën komunë i numrit të incidenteve dhe i reagimit ndaj incidenteve. Shkolla me menaxhim më efikas kishte më pak incidente, incidentet ishin trajtuar në mënyrë më efikase dhe me një qasje më të vendosur nga drejtori, nga mësimdhënësit, nga kujdestarët e klasës dhe nga prindërit. Shkollat ku menaxhimi është më efikas në parandalimin dhe reagimin ndaj incidenteve janë gjithashtu më të hapura për

¹⁰⁹ Kosova Education Center (KEC), «Impact of Learning Centers on Inclusion of Roma, Ashkali, and Egyptian Children in Education», KEC, Pristina 2018.

bashkëpunim me qendrat mësimore dhe me aktivistët e komuniteteve për ta përmirësuar rezultatin e nxënësve në shkolla.

Numri i nxënësve të komuniteteve në shkolla po ashtu duket të ketë ndikim në marrëdhëniet mes nxënësve. Në shkollat që kanë numër të konsiderueshëm të komuniteteve joshumicë, kishte më shumë ndërveprim, më shumë bashkëpunim dhe më shumë integrim mes nxënësve. Natyra e incidenteve në shkollat me numër të konsiderueshëm nxënësish të komuniteteve joshumicë po ashtu ndryshon në atë që ato janë më shumë të karakterit personal dhe jo të karakterit ndërkomunitar, të ngjashme me incidentet brenda të njëjtin komunitet. Fëmijët në këto shkolla mendojnë se nuk ka diskriminim ndaj tyre dhe ndihen të integruar dhe se përkasin me fëmijët e tjerë dhe me stafin mësimdhënës në shkollë.

Megjithatë, secila nga klasat më të larta kanë për ta treguar nga një rast që ka ndodhur si rezultat i trajtimit të pabarabartë. Hetimi i mëtejshëm i këtyre rasteve çoi tek mësimdhënës ose drejtorë të shkollave të cilët ose nuk janë të vetëdijshëm, ose janë mospërfillës ndaj detyrave dhe të përgjegjësive të tyre, ose nuk u përgjigjen nevojave të komuniteteve. Ka shumë mundësi, bazuar në rrëfimet e të anketuarve, vëzhgimet e hetimit dhe diskutimet me autoritetet e arsimit, që të njëjtët individë tregojnë të njëjtin nivel të neglizhencës për të gjitha komunitetet dhe për të gjitha përgjegjësitë e tyre.

Lidhur me qasjen e tërë sistemit, të intervistuarit theksuan se neglizhenca reflektohet si mungesë e masave sistematike afirmative dhe të barazisë që kanë në fokus anëtarët e komunitetit joshumicë (dhe në veçanti atyre rom, ashkali dhe egjiptian) që do të synonin regjistrimin e barabartë të nxënësve dhe nivele të barabarta të rezultateve në shkollë. Problemet vazhdojnë të ekzistojnë në forma të ndryshme, siç janë: mungesa e teksteve shkollore falas për nxënësit e komuniteteve (siç u theksua nga nxënësit e intervistuar në një qendër mësimore); diskriminimi në vlerësimin e nxënësve për të njëjtat njohuri (shumica e nxënësve të komuniteteve nuk kanë rezultate të mira në shkollë); djemtë që braktisin arsimin e mesëm të lartë për të mbajtur familjet e tyre; vajzat që detyrohen nga familjet e tyre ta lënë shkollën pas klasës së nëntë etj. Sipas tre nxënësve ashkalinj, tre nga shtatë nxënësit ashkalinj e kanë braktisur mësimin në një shkollë të mesme të lartë teknike, që nga fillimi i vitit shkollor (shtator deri në prill 2022). Sipas nxënësve të intervistuar, ata e kishin lënë shkollimin për shkak të rezultateve të dobëta. Nëse autoritetet e Kosovës nuk merren në mënyrë më aktive me këto forma më të thella të neglizhencës, ato mund të shndërrohen, nëse nuk janë shndërruar tashmë, në forma të diskriminimit kundër anëtarëve të komuniteteve.

Vlen të theksohet se shumica e të anketuarve nga radhët e komuniteteve të cenueshme, të cilët janë intervistuar, kanë theksuar se ka pasur përmirësime të dukshme gjatë pesë viteve të fundit në përfshirje dhe në aspekte të tjera të arsimit të komuniteteve. Një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim ka luajtur ndërgjegjësimi i shtuar i të gjithë faktorëve, përfshirë edhe anëtarët e komuniteteve. Ata e ilustruan këtë me disa shembuj kur mobilizimi i prindërve të komuniteteve, si ai individual ashtu edhe grupor, po ashtu mobilizoi autoritetet shkollore dhe komunale për t'i adresuar seriozisht rastet, të cilat përndryshe do të mbeteshin të pa trajtuara. Megjithatë ata shtuan se krizat e shkaktuara nga COVID-19 dhe mësimi online që rezultoi nga ai, shënuan një kthim të rëndësishëm mbrapa në procesin e përmirësimeve graduale që ishin si rezultat i politikave më afirmative të integritimit në vitet e fundit. Ndikimi

negativ i COVID-19 dhe mësimi online kanë qenë më e rënda veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.¹¹⁰

7. RËNDËSIA E ARSIMIT

Në këtë pjesë janë paraqitur dhe diskutuar shkurtimisht disa indekse dhe tregues ndërkombëtarë për t'i krahasuar me të dhënat e Kosovës dhe për të vlerësuar kontributin e shkollimit, siç përcaktohet në LAPRK, në nenin 2, nënparagrafi 2.1: *"Zhvillimi i personalitetit, talentit dhe aftësive mendore dhe fizike të nxënësit në potencialin e tyre të plotë."* Rezultatet nga testet e standardizuara (PISA dhe TIMMS) po ashtu përdoren në këtë seksion, së bashku me disa tregues dhe indekse ndërkombëtare që vlerësojnë rezultatin e sistemeve arsimore në Kosovë, në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në Evropë. Gjetjet e hulumtimit empirik po ashtu diskutohen në këtë pjesë për të kuptuar më mirë rolin dhe kontributin e shkollave në zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijëve dhe të të rinjve, sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore.

Që në fillim të këtij seksioni, vlen të theksohet se Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për 2021 gjeti: *"Është arritur pak progres në reformimin e sistemit arsimor. Shpenzimet publike për arsimin mbetën të pandryshuara në 4.7% të BPV-së në vitin 2020, që është e krahasueshme me mesataren e 27 vendeve të BE-së, por duke pasur parasysh popullsinë e re të Kosovës, shpenzimet për nxënës janë të pamjaftueshme, duke u fokusuar kryesisht në pagesën e mësimdhënësve. Për më tepër, shkollave u mungojnë materialet arsimore, ndërsa për zgjedhja e mësimdhënësve ndikohet nga politika."* Raporti vazhdon t'i radhisë çështjet dhe mangësitë kryesore në sistemin arsimor të Kosovës, vetëm për të rritur edhe më shumë imazhin e zymtë të gjendjes në sistemin arsimor të Kosovës dhe paaftësinë e tij për t'i përmbushur detyrimet e veta kushtetuese për respektimin e të drejtave të fëmijëve në arsim. Më poshtë janë dhënë një numër treguesish që shërbejnë për ta analizuar gjendjen në arsimin kosovar nga këndvështrimi i përmbushjes së të drejtave të fëmijëve në arsim, siç parashihen me instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe vendore.

7.1. Kontributi i arsimit në zhvillimin e potencialit të nxënësve

Programi për Zhvillimin e Kombeve të Bashkuara (UNDP) përditëson Indeksën e Zhvillimit Njerëzor (IZhNj) çdo vit që nga viti 1990, në mënyrë që t'i plotësojë të dhënat dhe informacionet mbi zhvillimin e vendeve individuale përtej raporteve të thjeshta të BPV-së. IZhNj-ja është indeks përmbledhës, i cili mat arritjen mesatare në tri dimensione bazë të zhvillimit njerëzor: jetën e gjatë dhe të shëndetshme, arsimimin dhe standardin e jetesës.¹¹¹ Renditja nga UNDP-ja e vendeve dhe e territoreve bazuar në IZhNj-në e tyre, nga e fundit te e para, për vitin 2016, tregon se IZhNj-ja e Kosovës (në 0.741) është më e ulët se ajo e Malit të Zi (0.802), e Serbisë (0.771) dhe e Republikës së Maqedonisë së Veriut (0.747), ndërsa pak më lart se IZhNj-ja e Shqipërisë dhe e Bosnjë e Hercegovinës (të dyja me 0.733), të radhitura në vendin e 85-të globalisht.¹¹² Ndërkohë që vendet e rajonit (përfshirë Shqipërinë dhe Bosnjë e Hercegovinën) kanë bërë përparim të konsiderueshëm mes viteve 2016 dhe 2020, duke u ngjitur për 10-20 vende më lart në listën për vitin 2020¹¹³, të dhënat për Kosovën

¹¹⁰ IAP, Raporti Vjetor 2021, fq.55.

¹¹¹ <https://hdr.undp.org/en/content/human-development-index-hdi> shikuar më 17 shkurt 2022.

¹¹² UNDP - Kosovo, «Human Development Report for Kosovo - 2016», UNDP, Pristina 2016.

¹¹³ Mali i Zi renditet si i 48-ti, Serbia e 64-ta, Shqipëria e 69-ta (nga pozita e 85-të), dhe Bosnjë dhe Hercegovina e 73-ta (nga pozita e 85-të).

mungojnë fare në renditjen e publikuar për vitet përtej 2016-ës.¹¹⁴ Pavarësisht kësaj, është e vështirë të pritet një përmirësim nga ana e Kosovës, kur merren parasysh treguesit e tjerë të rezultetit të sistemit që janë paraqitur në këtë dokument. Sidoqoftë, është befasues që Raporti i Zhvillimit Njerëzor i UNDP-së nuk e përfshin Kosovën në listën e vendeve, ose në kategorinë e *territoreve të tjera*, siç ishte rasti me Raportin e vitit 2016. Në vend të kësaj, vetëm një tregues (Raporti i varësisë) që i referohet Kosovës në tablonë socio-ekonomike raportohet nën Serbi.¹¹⁵

Në vitin 2018, Banka Botërore filloi të aplikonte në rrafshin global konceptin e Indeksit të Kapitalit Njerëzor (IKNj), i cili merr në konsideratë të dhëna të ngjashme si IZhNj-ja për matjen e produktivitetit të gjeneratës së ardhshme të punëtorëve për 157 vende në nivel kombëtar. IKNj-ja e Bankës Botërore mund të përdoret drejtpërdrejt për të vlerësuar rëndësinë e arsimit në Kosovë, d.m.th. zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore për zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijës përmes ndërhyrjeve shoqërore dhe shtetërore. Pra, ai jep përgjigje në pyetjen: cilat janë gjasat (në përqindje) që një fëmijë kosovar të jetë i suksesshëm në jetë bazuar në shërbimet shëndetësore, arsimore dhe sociale të ofruara nga shteti? IKNj-ja është ndërtuar mbi disa komponentë kryesorë, siç janë: cilësia e kujdesit shëndetësor, jetëgjatësia e pritshme dhe cilësia e arsimit dhe e shkollimit. Janë dy të dhëna të rëndësishme të llogaritura nga ekspertët e Bankës Botërore për vështirësitë në jetë të fëmijëve kosovarë që rezultojnë nga kujdesi shoqëror dhe investimi në arsimimin e tyre.¹¹⁶

Së pari, një fëmijë i lindur sot në Kosovë, kur të rritet, do të jetë **57 për qind produktiv** nga ajo që do të mundë të ishte po të gëzonte arsimim të plotë dhe shëndet të plotë. Sipas Bankës Botërore, kjo është më e ulët se mesatarja për Evropën (rreth 75%), por pak më e lartë se mesatarja për vendet me të ardhura të mesme të larta. Është e rëndësishme të theksohet këtu se nga treguesit që janë marrë në konsideratë për IKNj-në, kujdesi shëndetësor i Kosovës jep një kontribut pozitiv për IKNj-në e Kosovës. Në fakt janë të dhënat e arsimit ato që e ulin rezultatin për Kosovën. Së dyti, nga 13.2 vitet e pritura të mësimin në sistemin e shkollimit, një nxënës kosovar përfiton mesatarisht 7.9 vite gjatë arsimit të tij parauniversitar. Kjo do të thotë se nxënësit kosovarë humbasin mesatarisht 5.3 vite të shkollimit në arsimin e Kosovës.

7.2. A i përgatit arsimi nxënësit për jetën ?

Rezultatet e testit PISA (2015 dhe 2018) - Duke analizuar rezultatin e sistemit nga perspektiva e trendëve, siç paraqitet në raportin e OECD-s për Arsimin në Ballkanin Perëndimor¹¹⁷, një krahasim i shkurtër i rezultateve të testit PISA për nxënësit 15-vjeç të vendeve të Ballkanit Perëndimor midis 2015 dhe 2018 tregon: (1) Kosova është ndër vendet me rezultatet më të ulëta në botë dhe (2) të gjitha vendet në rajon kanë bërë rritje statistikore të rëndësishme të rezultateve (prej 6 deri në 16%), me përjashtim të Kosovës që ka përmirësuar rezultatet me 6 pikë statistikore të parëndësishme në rezultatin të përgjithshëm. Kjo tregon se përveç rezultetit më të ulët në arsim në përgjithësi, sistemi i arsimit në Kosovë nuk po shfaq shenja përmirësimi, i cili, sipas të gjitha gjasave, vetëm se është përkeqësuar edhe më shumë për shkak të pandemisë COVID-19 në dy vitet e fundit.

¹¹⁴ UNDP, «Human Development Index (HDI) Ranking 2020», UNDP, New York 2021.

¹¹⁵ <https://hdr.undp.org/sites/default/files/hdr2019.pdf>, Shih faqet 344 dhe 347!

¹¹⁶ The World Bank Group, «Human Capital Index,» World Bank, Washington, 2020.

¹¹⁷ OECD, «Education in the Western Balkans: Findings from PISA,» OECD Publishing, Paris, 2020

Ngjashëm me rezultatet në testin e standardizuar ndërkombëtar PISA, nxënësit kosovarë të klasës së katërt patën rezultat të dobët edhe në testin e standardizuar TIMSS për matematikë dhe shkencë. Sipas faqes zyrtare të organizatorëve (TIMSS & PIRLS), nxënësit kosovarë shënuan 444, respektivisht 413 pikë mesatare në matematikë dhe shkencë - më e ulëta në mesin e vendeve evropiane dhe ndër dhjetë rezultatet më të ulëta në nivel global.¹¹⁸

Analfabetizmi funksional në radhët e nxënësve 15 vjeç - Një raport i Bankës Botërore¹¹⁹ mbi ndikimin e COVID-19 në vendet e Ballkanit Perëndimor bazuar në shqyrtimin e rezultateve të PISA 2018, sipas vendeve, tregon se mbi 78 për qind e 15-vjeçëve në Kosovë dhe mbi 50 për qind e të tillëve në Shqipëri, në Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi janë analfabetë funksionalë (me rezultat nën nivelin 2¹²⁰ të aftësisë në PISA), krahasuar me 23 për qind në vendet e OECD-s. Madje edhe në Serbi, e cila ka rezultatin më të mirë në Ballkanin Perëndimor, 38 për qind e nxënësve janë analfabetë funksionalë. Kjo do të thotë se nxënësit e Kosovës nuk i fitojnë aftësitë bazë të nevojshme për të funksionuar në mënyrë efektive në një fuqi punëtore moderne. Rrjedhimisht, sistemi i arsimit në Kosovë dështon në mënyrë të ndjeshme (me një shkallë të analfabetizmit funksional prej 78%) në dy funksione kryesore: shkrim-lexim dhe zhvillim të fëmijëve. Niveli i ulët i shkrim-leximit reflektohet më vonë në mungesën e gatishmërisë së të rinjve për lëvizshmëri shoqërore dhe për t'u bërë me sukses pjesë e tregut të punës përtej punëve që kërkojnë aftësi të ulëta.

Një analizë e gjendjes nga Banka Botërore¹²¹ gjeti një korrelacion të fortë midis ofrimit të edukimit dhe arsimit në fëmijërinë e hershme dhe niveleve të shkrim-leximit (analfabetizmit) funksional tek 15-vjeçët. Ata theksojnë se qasja e ulët në edukim në fëmijërinë e hershme në vend dhe cilësia e ulët e shërbimeve ndikon negativisht në zhvillimin e përgatitjes për shkollë dhe në ngritjen e aftësive themelore të shkrim-leximit dhe të njohuritë për numrat. Gjendja është edhe më e zymtë kur bëhet fjalë për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Niveli i tyre i shkrim-leximit dhe i njohurive për numrat është edhe më i ulët sesa mesatarja e Kosovës. Përderisa gjendja e përgjithshme është shumë e zymtë, duket se në rastin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vërehen pabarazi e konsiderueshme, e theksuara dhe e analizuar edhe nga analiza e Bankës Botërore edhe gjatë hulumtimit empirik për këtë Raport.

7.3. Ndikimi i pandemisë COVID-19 në rezultatin e shkollimit në Kosovë ?

Si kudo tjetër në botë, rezultati i sistemit arsimor në Kosovë është prekur në mënyrë kritike nga pandemia COVID-19 viteve të fundit. Pandemia COVID-19 ka shumë të ngjarë ta kufizojë edhe më tej kapacitetin e sistemit arsimor të Kosovës për të punuar drejt përmbushjes së plotë të të drejtave të nxënësve në arsim për zhvillimin e plotë të potencialit të tyre në përputhje me nevojat e tyre specifike. Në fakt, ekspertët e Bankës Botërore llogaritën humbjet në mësim për shkak të pandemisë COVID-19¹²² menjëherë pas fillimit të

¹¹⁸ <https://timss2019.org/reports/>

¹¹⁹ World Bank Group, "The Economic and Social Impact of Covid 19 - Education," World Bank Group, Washington, Spring 2020.

¹²⁰ Niveli 2 është niveli bazë, niveli i aftësisë në të cilin nxënësit fillojnë të demonstrojnë kompetencat që do t'u mundësojnë atyre më vonë të marrin pjesë në mënyrë efektive në jetë si studentë, punëtorë dhe qytetarë. OECD 2017.

¹²¹ M. A. e. a. Angela Demas, A Situational Analysis of the Early Childhood Development (ECD) Services in Kosovo, Washington: World Bank Group, 2021, p. 9.

¹²² World Bank Group, "The Economic and Social Impact of Covid 19- Education," World Bank Group, Washington, Spring 2020.

saj në vitin 2020. Ata llogaritën ndikimin e pandemisë si për (i) mbylljen totale, ashtu edhe për (ii) skenarët e mësimit online në pjesën e parë të vitit 2020. Ata zbuluan se nxënësit do të humbnin prej 9 pikë PISA (nëse nxënësit do mësonin online) në 16 pikë të PISA-s (në rastet kur shkollat mbyllën pjesërisht ose plotësisht) gjatë gjysmës së parë të vitit. Për ta pasur një pasqyrë më të plotë të ndikimit negativ të pandemisë, vlen të theksohet se një nxënës do të mësonte mesatarisht rreth 40 pikë të PISA-s gjatë një viti të plotë shkollor. Humbja ndërmjet 9 dhe 16 pikëve të PISA-s do ta shtynte në Kosovë rezultatin e leximit në nivelin e saj të vitit 2015 (prej 347 pikëve në PISA) dhe do të zhbënte progresin e vogël i bërë ndërmjet viteve 2015 dhe 2018.¹²³

Ekspertët e Bankës Botërore llogaritën gjithashtu se mbyllja e shkollave do t'i thellonte më tej pabarazitë ekzistuese midis nxënësve "Dallimi në arritje në mes të nxënësve më të varfër dhe atyre më të pasur, i cili tashmë sillet nga 1.5 vite shkollim në Shqipëri, BeH dhe Kosovë (66 pikë PISA) deri në mbi 2 vjet në Maqedoninë e Veriut (90 pikë PISA) do të rritet më tej pasi nxënësit më të varfër kanë më pak gjasa të përfitojnë nga metodat e mësimit online."¹²⁴ Më tej ekspertët e Bankës Botërore vlerësuan se nxënësit më të varfër dhe me rezultat më të ulët do të humbnin nga 1.5 deri në 2 vite shkollore. Implikimet e mëtejshme të COVID-19 për arsimin në Kosovë me siguri do të përfshijnë rritjen e nivelit të analfabetizimit funksional (përtej 80% të nxënësve të tanishëm 15-vjeç) dhe zgjerimin e dallimit në rezultatet PISA mes Kosovës dhe vendeve fqinje në disfavor të nxënësve të Kosovës. Në këtë perspektivë të zymtë është e pamundur të mos mendohet për grupet e cënueshme, siç janë nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët tashmë veçse kishin qenë prapa në krahasim me komunitetet e tjera në kohën para pandemisë. Për nxënësit individualë, gjendja e atyre që edhe ashtu kishin ngecur prapa, do të përkeqësohet edhe më tej duke rënë më thellë në analfabetizëm funksional, duke rritur kështu pasqyrën e zymtë për të ardhmen e të rinjve të Kosovës dhe të Kosovës si shtet i ri. Në relacion me këtë, me qëllim të përmirësimit të situatës, IAP në vitin 2021 në raportin emergjencë shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, i ka rekomanduar MASHT-it që të hartoj strategji për kompensimin e mësimit të humbur, kthimit në proces mësimor të fëmijëve që për arsye të masave anti covid nuk kanë marr pjesë në procesin e shkollimit ose e kanë braktisur shkollimin.

7.4. Rëndësia e financimit të arsimit

Një tregues i rëndësishëm i rezultatit të sistemit arsimor në Kosovë është raporti mes shpenzimeve kumulative për nxënës (të moshës 15 vjeç) në arsim dhe rezultatit në testin PISA. Raporti i OECD-s mbi rezultatet e PISA-s për vendet e Ballkanit Perëndimor tregon rezultatet e sistemit për Serbinë, për Malin e Zi, për Maqedoninë e Veriut dhe për Bosnjë e Hercegovinën, por nuk përfshin rezultatet për Shqipërinë dhe për Kosovën. Megjithatë, sipas analizës së OECD-s, Serbia dhe Mali i Zi kanë rezultat më të lartë sesa pritej (bazuar në shpenzimet e tyre), ndërsa Bosnja dhe Maqedonia e Veriut kanë rezultat më ulët sesa pritej.

Bazuar në faktin se shpenzimet e Kosovës në arsim (4.0% e BPV-së) janë përafërsisht të njëjta me ato të vendeve të tjera të rajonit (midis 3.7 - 4.5% të BPV-së), atëherë është e mundur të matet rezultati i sistemit arsimor të Kosovës duke krahasuar rezultatet e Kosovës në PISA me ato të vendeve të tjera të rajonit. Në këtë rast, duke pasur rezultatet më të ulëta,

¹²³ Të dhënat e PISA 2018 dhe llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.

¹²⁴ World Bank Group, "The Economic and Social Impact of Covid 19- Education," World Bank Group, Washington, Spring 2020.

por me një investim të ngjashëm me atë të vendeve të tjera të rajonit, mund të arrihet në përfundimin se sistemi arsimor i Kosovës ka rezultat më të keq se ato të vendeve të tjera në rajon.

Një analizë e shkurtër e pagave të mësimit gjithashtu tregon se rezultati i sistemit të shkollimit në Kosovë është në mënyrë joproportionale më i ulët se ai i vendeve të rajonit¹²⁵ (shih në Shtojcën 8 të raportit - Krahasimi i pagave të mësimit në vendet e Ballkanit Perëndimor).

Domethënë, nxënësit në Shqipëri, të cilët mësohen nga mësimit që marrin paga më të ulëta se mësimit e Kosovës, kanë rezultate dukshëm më të mira në testin PISA sesa nxënësit kosovarë. Në mënyrë të ngjashme, nxënësit në Serbi dhe në Maqedoninë e Veriut, që mësohen nga mësimit me paga pak (10-12%) më të larta të mësuesve, kanë rezultat dukshëm (12-20 %) më të mirë se nxënësit kosovarë në testin PISA. Është shumë me rëndësi që autoritetet e arsimit të Kosovës të rishpërdajnë fondet në arsim nëse qëllimi është rezultati më i mirë i sistemit dhe rezultatet e nxënësve. Arsytet për këtë gjendje mund të jenë të shumta. Studimi i lartcekur i OECD-s identifikoi disa arsye, duke përfshirë madhësinë dhe rrjetin joefikas të shkollave, numrin e tepërt të mësimit në shërbim (raport i ulët nxënës/mësimit) dhe mungesën e teknologjisë së arsimit dhe materialeve mësimore në shkolla. Sipas Zyrës SMIA në MASHTI, Kosova ka shpenzuar shumë të ngjashme fondesh me ato që shpenzojnë vendet e tjera të rajonit për arsimin parauniversitar, por më të ulëta se mesatarja e BE-së dhe OECD-s.

Shpërndarja reflekton nivelin e ulët të përfshirjes në arsimin parashkollor (0.1%). Edhe shuma e arsimit parashkollor dhe parafillor është tepër e ulët, veçanërisht kur merret parasysh numri i lartë i fëmijëve (rreth 130.000) në pesë grupet e edukimit dhe arsimit parashkollor (mosha 2-6 vjeç) në Kosovë.

Kësaj mund t'i shtohet edhe struktura joefikase e shpenzimeve në arsim. Në fakt, bazuar në të dhënat e MFPT-së¹²⁶, Buxheti i Kosovës ka ndarë 194.8 milionë euro për grantin specifik për arsimin parauniversitar për të gjitha komunat për vitin 2021. Prej tyre, 175.5 milionë € (ose 90% e grantit) janë ndarë për paga, 14.5 milionë € (më pak se 1% e shumës totale) për mallra dhe shërbime dhe një shumë e vogël prej 2.4 milionë € për investime kapitale. I njëjti dokument parasheh edhe ndarjen e 1.6 milion eurove për arsimin parafillor. Kjo shpërndarje lë pak ose aspak hapësirë për investime për materialet mësimore dhe për kushtet e punës (që do të bien në mallra e shërbime dhe investime kapitale). Shpërndarja joefikase e fondeve në arsim po ashtu konfirmohet edhe në Raportin e BE-së për Kosovën për vitin 2021.¹²⁷ E thënë me fjalë të tjera, pas luftës së vitit 1999, në sektorin e arsimit, Kosova ka investuar shumë në objektet shkollore dhe në personelin mësimit, por nuk ka krijuar kushte për mësimit dhe mësimit cilësor në klasë - aty ku zhvillohet arsimi.

7.5. Përshtatshmëria e arsimit në Kosovë sipas nxënësve, personelit dhe prindërve

¹²⁵ European Commission/EACEA/Eurydice, Teachers' and School Heads' Salaries and Allowances in Europe-2019/20. Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2021, p. 15. - Të dhënat për Kosovën janë shtuar nga ekipi hulumtues.

¹²⁶ MFPT, «Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023», Prishtinë 2021.

¹²⁷ "Shpenzimet publike të Kosovës për arsim në vitin 2020 mbetën të pandryshuara, në 4.7% të BPV-së. Megjithatë, shpenzimet për nxënës mbeten të pamjaftueshme, me shpenzime të fokusuar në paga dhe shpenzime kapitale e jo në arsim cilësor."

Hetimi empirik ka vërtetuar se sistemi arsimor dhe shkollat në Kosovë nuk ia dalin t'i ofrojnë në mënyrë të organizuar dhe sistematike shërbimet kryesore që do ta bënin shkollimin të përshtatshëm për zhvillimin e potencialit të plotë të nxënësve.

Gjatë diskutimeve dhe intervistave në fokus-grupe për **rëndësinë e shkollave**, të gjithë pjesëmarrësve iu bë e njëjta pyetje fillestare: Çfarë u ofron shkolla juaj nxënësve? Përgjigjet më të shpeshta ishin se shkollat ofrojnë *njohuri, mësimnxënie dhe mësimdhënie*. Prandaj hetimi vetëm konfirmoi se shkollat në Kosovë janë të fokusuara kryesisht në bartjen e përmbajtjes së kurrikulave tek nxënësit e tyre. Më rrallë, të anketuarit përmendën aftësitë, shkathtësitë për jetë, mbështetjen dhe shoqërimin. Kur u pyetën për të shtjelluar më tej për aftësitë që kanë marrë në shkollë, ata kryesisht iu referuan aftësive akademike si leximi dhe shkrimi, por përmendën edhe aftësitë e prezantimit, punën në grupe, debatet etj.

Rrallëherë pjesëmarrësit iu referuan aktiviteteve shkollore, mbështetjes psikologjike, mësimdhënies dhe mësimnxënies atraktive, mbështetjes së nxënësve, shënimit të ditëve ndërkombëtare dhe kombëtare, kuizeve, aktiviteteve sportive, aktiviteteve të klubeve të gjelbra (ekologjike) etj. Megjithatë, këto zakonisht janë iniciativa individuale që vijnë nga mësimdhënës, drejtorë, nxënës entuziastë dhe, me raste, nga prindër që angazhohen më shumë. Pjesëmarrësit nuk mbanin mend ndonjë mbështetje nga autoritetet komunale ose qendrore të arsimit për të zbatuar iniciativat dhe aktivitetet e tyre bazë dhe shtuan se ata e kishin bërë këtë në baza vullnetare me mjetet e tyre ose duke përdorur mjetet e kufizuara të shkollës.

Të pyetur për mbështetjen e dhënë për të identifikuar dhe zhvilluar aftësitë dhe talentet e nxënësve, pjesëmarrësit iu referuan mbështetjes nga mësimdhënësit, aktiviteteve për shënimin e ditëve ndërkombëtare, aktiviteteve të klubeve të gjelbra, orëve private të mësimi, angazhimit në klube sportive dhe aktiviteteve jashtë shkollave etj. Një prind në një diskutim në fokus-grup këmbënguli: *"Në shkollat e Kosovë nuk bëhet përgatitja për jetë; arsimit përbehet nga përmbajtjen mësimore, nuk ofrohet mbështetje për nxënësit, nuk ofrohen shërbime profesionale, janë vetëm lëndët dhe përmbajtja."* Një numër i shkollave të vizituara organizojnë aktivitete të ngjashme me klubet e nxënësve për pikturë, muzikë, dramë, ekologji, debate e kështu me radhë, por edhe këto janë jetëshkurtra për shkak të mungesës së mbështetjes dhe angazhimit të qëndrueshëm. Këto aktivitete fitojnë në intensitet dhe rëndësi kryesisht kur festohen ditë të rëndësishme kombëtare. Është interesante se në mesin e këtyre aktiviteteve të klubeve të nxënësve nuk u përmendën klubet shkencore apo klubet e teknologjisë. Shkollat në Kosovë nuk ofrojnë ndonjë angazhim sistematik për nxënësit e tyre në aktivitetet e klubeve pas kohës së mësimi. Ata thanë se kjo ndodh për shkak të mungesës së fondeve, mungesës së ambienteve (në shkollat urbane), mungesës së pajisjeve dhe rekuizitave si dhe për kohën e shkurtër që e kanë në dispozicion për shkak se shkollat punojnë në dy ndërrime.

Një element i rëndësishëm për ta bërë shkollimin e përshtatshëm për nxënësit është futja e lëndëve zgjedhore në kurrikulën shkollore. Megjithatë, të gjithë nxënësit, prindërit dhe një numër mësimdhënësish deklaruan se "askush nuk i pyet ata për përmbajtjen dhe organizimin e lëndëve zgjedhore, pasi vendimi për to merret diku tjetër për qëllime të tjera e jo për interesin më të mirë të nxënësve". Duket se DKA-të i përdorin lëndët zgjedhore për të kompensuar orët që u mungojnë mësimdhënësve të tyre të preferuar. Sipas nxënësve të intervistuar, edhe kur organizohen lëndë zgjedhore, ato nuk mësohen në mënyrë adekuate dhe nuk ka materiale mësimore në dispozicion për mësim cilësor.

Asnjë nga shkollat e vizituara nuk ofron mbështetje sistematike të këshillimit për karrierë për nxënësit dhe si rrjedhojë nuk kanë personel drejtpërdrejt përgjegjës për këtë funksion të rëndësishëm për çdo shkollë moderne. Një mësimitdhënës i intervistuar deklaroi se ata bëjnë çmos për t'i ndihmuar nxënësit e tyre në zgjedhjen e profesionit të tyre të preferuar. Megjithatë, entuziazmi i tyre nuk pasohet nga instrumentet e vlerësimit, trajnimet përkatëse, koha e konsultimit, shkëmbimi i praktikave të mira me kolegët etj. Madje, siç e thanë ata, as nuk e kanë kohën e nevojshme për t'u angazhuar në përpjekje të tilla.

Një numër shkollash kanë psikologë të shkollës që po bëjnë më të mirën duke punuar me fëmijët dhe nxënësit. Megjithatë, bazuar në intervistat me ta, atyre u mungon mbështetja për t'i ndihmuar më mirë nxënësit. Për shembull, pasi të jenë punësuar së fundmi, ata konsiderohen si personel i ri dhe nuk e kanë ndikimin e nevojshëm për të pasur ndikimin e duhur në shkollë. Duke mos pasur mundësi të punojnë në mënyrë aktive me kolegët e tyre (përmes trajnimeve), psikologët e shkollave mbështeten më shumë në punën me nxënësit. Roli i tyre varet kryesisht nga mbështetja që marrin nga drejtorët e shkollave. Sipas psikologëve të intervistuar, disa drejtorë i mbështesin më shumë, ndërsa të tjerët nuk e konsiderojnë aq të rëndësishëm këtë shërbim profesional. Një pengesë që këta të kenë ndikim më të mirë është fakti që psikologët e shkollave janë të përbashkët për dy e më shumë shkolla. Kjo u jep atyre një lloj karakteri të përkohshëm dhe punë me orar jo të plotë në shkollat ku ata angazhohen.

Mungesa e një baze të fortë teknologjike është një nga mangësitë kryesore të shkollave në Kosovë sot. Kjo duket të jetë një nga arsyt kryesore që arsimit nuk është i përshtatshëm dhe pse shkolla nuk mund të kontribuojë në mënyrë adekuate në zhvillimin e potencialit të nxënësve. Në fakt dihet që nxënësit janë shumë përpara shkollës dhe mësimitdhënësve të tyre në aspektin e aplikimit të teknologjive të reja. Kur diskutohet për përdorimin e teknologjisë në shkollat e tyre, pjesëmarrësit në diskutimet në fokus-grupe dhe të intervistuarit kryesisht mendojnë dhe u referohen laboratorëve kompjuterikë/TIK. Fatkeqësisht këta laboratorë zakonisht përbëhen nga kompjuterë të vjetër dhe shihen si të lidhur vetëm me lëndën e TIK-ut. Asnjëra nga shkollat e vizituara nuk kishte bazë teknologjike me të cilën do të mundë të mburreshin. Muret e klasave janë kryesisht të zhveshura, zakonisht nuk ka kompjuterë dhe laboratorë në to, shpesh ka një projektor, por nuk ka kompjuter për ta lidhur ose e kundërta, nuk janë vërejtur tabela të mençura në asnjë nga institucionet arsimore të vizituara dhe nuk ka softuer për t'u përdorur në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie të lëndëve të tjera, përveç TIK-ut. Fakti se qasjet e reja në aplikimin e teknologjisë në mësimitdhënie nuk u përmendën nga pjesëmarrësit në intervista dhe në fokus-grupe, nënkupton se mësimitdhënësit dhe prindërit, por edhe nxënësit, janë larg aplikimit të qasjeve inovative në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie në shkollat e Kosovës.

Kur u pyeten për laboratorët dhe teknologjinë e përdorur në lëndë të tjera, pjesëmarrësit u referoheshin laboratorëve të vjetër të fizikës, të kimisë dhe të biologjisë (shpesh të vendosur në të njëjtën sallë), të cilët nuk janë mobiluar për dekada të tëra. Më së shpeshti, personeli i shkollave në zonat urbane thotë se u duhej t'i kthenin laboratorët në klasa për të liruar më shumë hapësirë për numrin gjithnjë e më të madh të nxënësve/klasave, sepse pajisjet ose ishin dëmtuar ose ishin vjetruar. Në shkollat e vizituara nuk diskutohet për pajisjet digjitale, për laboratorët digjitalë, për pajisjet robotike, për printerët 3D apo për teknologjitë inovative. Në shkollat rurale si rregull nuk ka laboratorë të shkencave natyrore. Ndoshta pasi ato shkolla janë të vogla dhe konsiderohet si shumë e shtrenjtë të ofrohen tre laboratorë shkencorë për një numër të vogël të nxënësve.

Kur u pyetën për rolin e tyre si mësimdhënës në shkollat e tyre, mësimdhënësit u përgjigjën me një listë të gjatë të funksioneve, duke e parë veten jo vetëm si mësimdhënës, por edhe si prind, psikolog, roje, mik, polic, mjek, udhërrëfyes në jetë etj. Ata gjithashtu iu referuan rolit të tyre si persona me detyra të shumta, të gjithanshme, gjithëpërfshirëse dhe të ndërlikuara për t'i pasqyruar përgjegjësitë që mësimdhënësit kanë në punën e tyre të përditshme. Një nga mësimdhënësit madje këmbënguli: *"Puna jonë çdo ditë po bëhet më e ndërlikuar, por unë sot nuk jam asgjë, arsimit nuk është më prioritet, nuk vlerësohemi siç vlerësoheshim përpara."* Shumica e mësimdhënësve të intervistuar u pajtuan me këtë profilizim të profesionit të mësimdhënësit. Në fakt kjo duket të jetë e besueshme pasi disa funksione të shkollës (si: këshillimi për karrierë, identifikimi dhe mbështetja e nxënësve të talentuar, shërbimet psikologjike etj.), që nuk ofrohen në mënyrë të organizuar nga sistemi arsimor, ofrohen në mënyrë joformale nga mësimdhënësit. Problemi kryesor është se mësimdhënësit nuk marrin asnjë trajnim apo mbështetje në këtë drejtim dhe ata duhet të improvizojnë, të angazhohen në të mësuar të pavarur ose thjesht t'i kthehen rolit dhe zonës së tyre më të sigurt, që është: t'u mësojnë nxënësve përmbajtjen kurrikulare.

8. KONSTATIMET DHE REKOMANDIMET

Konstatimet

Pas analizimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, të dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të të dhënave që IAP-ja i ka, del se gjatë dekadës së fundit Kosova ka bërë përparim në fushën e zbatimit të të drejtave të njeriut në arsim. Ka pasur progres jo të barabartë në nënsektorë të ndryshëm sa i përket pjesëmarrjes, përfshirjes dhe zhvillimit të fëmijëve sipas nevojave dhe aftësive të tyre.

Sidoqoftë, ajo çfarë është shqetësuese është rezultati PISA në arsim në përgjithësi. Avokati i Popullit konsideron se cilësia e arsimit nuk është në nivelin e duhur për të përgatitur nxënësit për jetën dhe rikujton se komentari i nenit 29 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës nënvizon të drejtën individuale dhe subjektive për një cilësi specifike të arsimit.

Për më tepër, pandemia COVID-19 i dha një goditje të rëndë procesit të përmirësimeve të vazhdueshme në zbatimin e të drejtave të njeriut në sistemin arsimor të Kosovës. Të gjitha trendet dhe proceset pozitive ose kanë ngecur, në rastin më të keq (si ai për fëmijët me aftësi të kufizuara), ose janë kthyer mbrapsht gjatë pandemisë (mars 2020 - mars 2022).

Sa i përket pjesëmarrjes në arsim, me pak përjashtime, fëmijët shkojnë në shkollë. Me fjalë të tjera, për sa i përket pjesëmarrjes, Kosova në përgjithësi ka arritur pjesëmarrje pothuajse universale në arsimin e përgjithshëm parauniversitar, me përjashtim të arsimit parashkollor, ku të dhënat janë jashtëzakonisht të ulëta, përkundër disa përmirësimeve në rritje në vitet e fundit.

Avokati i Popullit vlerëson se situata nuk është e mirë as kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në arsim të fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe për pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Për kundër përparimeve të bëra në përmirësimin e pjesëmarrjes së fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim, ata ende mbeten dukshëm prapa komuniteteve të tjera, veçanërisht në arsimin parashkollor dhe në atë të mesëm të lartë.

Avokati i Popullit vlerëson se pjesëmarrja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në të nxënë në arsimin e rregullt ka shënuar progres, mirëpo është ende larg përfshirjes të paktën 50% të këtyre fëmijëve në arsimin e ofruar, siç parashihet me PSAK 2017-2021.

Sa i përket përfshirjes në arsim, përkundër mungesës së madhe të resurseve, shkollat janë përgjithësisht gjithëpërfshirëse dhe pranuese për të gjithë nxënësit, si dhe më miqësore dhe më të hapura ndaj diversitetit krahasuar me një dekadë më parë.

Avokati i Popullit gjithashtu vlerëson se mbetet shumë për të bërë në fushën e gjithëpërfshirjes në sistemi arsimor sidomos në evitimin e problemeve që ndërlidhet me performancën e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Ngjashëm, sistemi arsimor është ballafaquar me problemin e mungesës së teksteve shkollore për mësim në gjuhët boshnjake dhe turke, i cili pjesërisht është zgjidhur por që ka nevojë për përmirësim me qëllim të përmbushjes në plotëni të tij.

Avokati i Popullit vlerëson se sistemi arsimor në Kosovës nuk u mundëson nxënësve zhvillimin e potencialit sipas nevojave dhe aftësive të tyre, në pajtim me dispozitat kushtetuese.

Të gjithë treguesit, nga hetimi i dokumentacionit dhe gjetjet nga hulumtimi empirik, tregojnë se sistemi arsimor i Kosovës është larg nga mundësia për ta zhvilluar plotësisht potencialin e fëmijëve sipas nevojave dhe aftësive të tyre specifike. Shih shtojcën 9 të raportit, në formë tabelore përshkruan në mënyrë më të detajuar gjetjet e hetimit mbi zbatimin e të drejtave të njeriut të fëmijëve në arsim në Kosovë: *"Identifikimi i çështjeve kyçe në (mos)harmonizimin e shërbimeve arsimore me të drejtat e fëmijëve në arsimin e përgjithshëm parauniversitar në Kosovë"*.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *"Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore."* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *"(...) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla (...)."*

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

1. Të hartojë dhe zbatojë një strategji për të përmirësuar pjesëmarrjen, cilësinë dhe njohjen e hershme të aftësisë së kufizuar në të paktën dy vite të arsimit parashkollor (moshat 3 dhe 4), përfshirë përdorimin e ambienteve të shkollës për të hapur shërbime/grupe të edukimit parashkollor.
2. T'i rishikojë aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e ekipeve komunale të vlerësimit dhe të mbështetjes për ta siguruar vlerësimin e hershëm të fëmijëve dhe një rol më aktiv të qendrave burimore dhe të shkollave në vlerësimin e fëmijëve.
3. Të angazhohet drejtpërdrejt dhe t'i koordinojë politikat dhe praktikat me komunat dhe me shkollat për ta përmirësuar pjesëmarrjen në nivel të arsimit parashkollor.

4. Të hartojë dhe të zbatojë politika të reja lidhur me kohën që duhet kaluar në mësim në arsimin parauniversitar, veçanërisht në klasën parafilllore.
5. T'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar përfshirjen dhe përmirësimin e rezultateve të fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë, në të gjitha nivelet e arsimit.
6. Ta rregullojë, ta fuqizojë dhe ta rrisë mbështetjen për përmirësimin e funksionimit të qendrave mësimore në mbështetje të të gjithë fëmijëve që kanë nevojë për përfshirje dhe përmirësim të rezultateve në shkollë, në mënyrë që ta vazhdojnë shkollimin dhe ta kenë më të lehtë kalimin në nivele më të larta të arsimit.
7. Ta hartojë dhe ta zbatojë një plan të veprimit për furnizimin e shkollave me teknologji dhe me materiale të reja mësimore.
8. Ta rishikojë formulën ekzistuese për shpërndarjen dhe menaxhimin e fondeve në arsim, për ta lejuar delegimin e pushtetit në shkolla dhe më shumë investime në materialet mësimore, në teknologji të reja dhe në kushte të punës që lidhen drejtpërdrejt me mësimdhënien dhe me mësimnxënien (përfshirë edhe brenda në klasë).
9. Ta rishikojë udhëzimin administrativ që rregullon raportin mes nxënësve dhe mësimdhënësve dhe madhësinë minimale të klasës për t'i përmirësuar masat afirmative për edukimin e komuniteteve.
10. Të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar plotësisht tekstet shkollore për mësim në gjuhët boshnjake dhe turke në shkollat e Kosovës.
11. T'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar fonde shtesë për diversifikimin dhe përmirësimin e arsimit të ofruar në institucionet arsimore duke mundësuar këshillim cilësor për karrierë, për aktivitete psikologjike dhe për klubet e nxënësve (për teknologji, shkenca dhe art) për ta përmirësuar përfshirjen dhe rëndësisë e arsimit.

Komunave të Republikës së Kosovës


12. Të funksionalizohen ekipet e parandalimit dhe të reagimit në nivel të shkollës dhe të komunës, të rrisin bashkëpunimin dhe koordinimin mes të gjitha palëve të interesuara (përfshirë qendrat mësimore) për ta adresuar çështjen e braktisjes së shkollës dhe dhunën në shkollë, veçanërisht në arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.
13. Ta ketë prioritet dhe ta rrisin financimin për ofrimin e edukimit dhe të arsimit parashkollor dhe parafillor në komunë, për t'i shtrirë shërbimet parashkollore edhe në zonat rurale.
14. T'i delegojnë planifikimin dhe menaxhimin e plotë financiare në shkolla. T'i angazhojnë DKA-të në monitorimin e planifikimit dhe të menaxhimit të kujdesshëm.
15. Të angazhohen në zgjatjen e kohës mësimore në shkolla, me fokus në klasat parafilllore dhe në aktivitetet e nxënësve në klube të ndryshme (të paktën për shkencë, për art dhe për teknologji).
16. Të hartojnë dhe të zbatojnë fushata ndërgjegjësuese që i adresohen komuniteteve dhe prindërve në fushën e përfshirjes dhe të arsimit të fëmijëve dhe të të rinjve me aftësi të kufizuara.

Komunave të ndërmarrin masa

17. Shkollat të planifikojnë dhe të zbatojnë aktivitete që i angazhojnë nxënësit në aktivitete plotësuese shkollore dhe jashtëshkollore.
18. Shkollat të angazhohen në një qasje ekipore në adresimin e përfshirjes dhe të edukimit të nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e tyre.
19. Shkollat t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme me qëllim të hartimit të PIA-s për fëmijët me aftësi të kufizuar.
20. Shkollat ta përmirësojnë bashkëpunimin me prindërit dhe me komunitetet për ta përmirësuar cilësinë e arsimit në shkolla.
21. Shkollat ta bëjnë mësimdhënien dhe mësimnxënien të orientuar drejt nxënësit dhe më tërheqëse, duke u larguar pak nga mbajtja e thjeshtë e mësimit dhe bartja e njohurive.
22. Shkollat të bashkëpunojnë me organizatat e komuniteteve dhe me prindërit për ta përmirësuar përfshirjen në shkolla të të gjitha komuniteteve dhe të grupeve të nxënësve.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Naim Qelaj

Avokat i Popullit

Shtojca Nr. 1

Shifrat për popullatën e nxënësve në Kosovë sipas niveleve, viti shkollor 2021/2022

Niveli	Publik			Privat			Gjithsej		
	M	F	Gjithsej	M	F	Gj	M	F	Gj
Parashkollor (mosha 0-<5)	2558	2379	4937	2803	2571	5374	5361	4950	10311
Parafillor (mosha 5-<6)	10065	9429	19494	1350	1242	2592	11415	10671	22086
Fillor / i mesëm i ulët	112666	105311	217977	3526	2926	6452	116192	108237	224429
I mesëm i lartë	34306	32832	67138	1869	1843	3712	36175	34675	70850
Gjithsej	159595	149951	309546	9548	8582	18130	169143	158533	327676

Shtojca Nr. 2

Hartëzimi i arsimit parashkollor

	I detyrueshëm	Programet	Kohëzgjatja	Mosha	Niveli ISCED 2011	
					Klasifikimi	Kodi tre shifrorë
1	Jo	Parashkollor-çerdhe	3 vjet	0 - 2	ISCED 01	010
2	Jo	Parashkollor-kopsht i fëmijëve	2 vjet	3 - 4	ISCED 02	020
3	Jo	Parafillor	1 vit	5	ISCED 03	020

Shtojca Nr. 3

Pjesëmarrja në arsimin parashkollor dhe parafillor publik dhe privat, viti shkollor 2021/22

Niveli	Publik			Privat			Gjithsej		
	M	F	Gj	M	F	Gj	M	F	Gj
Arsimi parashkollor (mosha 0-<5)	2558	2379	4937	2803	2571	5374	5361	4950	10311
Parafillor (mosha 5-<6)	10065	9429	19494	1350	1242	2592	11415	10671	22086

Shtojca Nr. 4

Statistikat e pjesëmarrjes së nxënësve me aftësi të kufizuara për vitet 2015/16; 2016/17 dhe 2017/18; 2018/19; 2019/20

Viti	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19	2019/20
Klasa të rregullta	5.815	5.294	4.451	3.645	3.903
Shkolla speciale	357	271	315	365	349
Gjithsej	6.172	5.565	4.766	4.010	4.252

Shtojca Nr. 5

Niveli i zbatimit të treguesve në lidhje me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në PSAK 2017-2021

Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parafillor.	53.9%	70%	44.9%
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor.	85.3%	95%	84.1%
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të ulët.	65%	85%	63.7%
Përfshirja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin e mesëm të lartë.	30.3%	50%	31%
Shkalla e kalimit në arsimin e mesëm të lartë e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian.	69.9%	80%	70.79%

Shtojca Nr. 6

Masat afirmative në nivel të sistemit për komunitetet joshumicë në arsimin e Kosovës

Nr.	Kriteret për krahasim	Shumicë	Joshumicë
1	Raporti nxënës-mësimdhënës Arsimi i përgjithshëm	21.3	14.2
1a	Raporti nxënës-mësimdhënës Arsimi profesional	17.2	11.5
2	Financimi për nxënës ¹²⁸	€ 23	€ 25
3	Madhësia min. e klasës	21/14	14
4	Për të hapur një shkollë Madhësia min. e shkollës fillore	60 nxënës	30 nxënës
5	Për të hapur një shkollë Madhësia min. e shkollës mesme të ulët	100	50
6	Për të hapur një shkollë ¹²⁹ Madhësia min. e shkollës së mesme të lartë	180	90

¹²⁸ Ministria e Financave, «Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023», MFT, Prishtinë 2021.

¹²⁹ MASHT, «Kriteret dhe procedura për themelimin dhe përfundimin e aktivitetit të institucioneve të arsimit në Kosovë», MASHTI, Prishtinë 2021.

Shtojca Nr. 7

Regjistrimi në arsimin parauniversitar sipas përkatësisë etnike 2020/2021.

Niveli	Shqiptarë	Serbë	Turq	Boshnjakë	Goranë	Ashkali	Romë	Egjiptianë	Kroatë	Tjerë	% com
EFH	5.189	9	6	3	/	4	7	21	/	/	0.1
Parafillor	19.201	34	190	194	34	213	84	61	2		3.8
Fill. i mesëm i ulët	213.112	229	1.781	2.427	386	3.755	1.067	1.123	20	5	4.7
I mes. i lartë	68.697	148	587	764	6	224	170	139	1	6	3.0
Gjithsej	305.157	418	2.564	3.338	426	4.195	1.328	1.336	23	11	4.3

Shtojca Nr. 8

Krahasimi i pagave të mësimdhënësve në vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendi Niveli ISCED	Shqipëria	Bosnjë dhe Hercegovina	Kosova	Mali i Zi	Maqedonia e Veriut	Serbia
ISCED 0	4189	6120		9715	6624	6330
ISCED 1	4938	6528		9715	6811	7396
ISCED 2-4	5132	6936	5760	9715	6811	7396
ISCED 3-4	5423	8160	6480	9715	7111	7396

Shtojca Nr. 9

Identifikimi i çështjeve kryesore në (mos)harmonizimin e shërbimeve arsimore me të drejtat e fëmijëve në arsimin e përgjithshëm parauniversitar në Kosovë

Niveli i arsimit	Çështjet kryesore	Shkaqet	Treguesit
Arsimi parashkollor	Pjesëmarrja e ulët.	Decentralizimi në nivel lokal dhe mungesa e resurseve.	7.5 % përfshirje.
	Mungesa e të mësuarit në edukimin e fëmijërisë së hershme (EFH).	EFH shihet vetëm si kujdes ditor.	EFH nuk ndikon në rezultatet në arsim (rezultatet e PISA-s).
	Vlerësimi i aftësive të kufizuara në të nxënë.	Mungesa e kapacitetit në nivel komunal për vlerësim dhe ndërhyrje shumëdisiplinore.	Njohja e aftësisë së kufizuar bëhet vetëm nga personeli shëndetësor.
	Përfshirja e komuniteteve joshumicë në edukimin parashkollor (EP).	Mungesa e kapacitetit në komuna.	Shkalla 0.1 e përfshirjes së komuniteteve në arsimin parashkollor.
	Pjesëmarrja e prindërve në financimin e EP-së.	Mungesa e fondeve komunale për organizimin e arsimit parashkollor.	Prindërit në institucionet publike të EP-së duhet të paguajnë 35-50 euro pjesëmarrje në muaj. Prindërit paguajnë 100-150 euro në muaj në institucionet private të EP-së.
Arsimi parafillor	Koha e pamjaftueshme e kaluar në shkollë.	Mungesa e hapësirës, e personelit dhe e resurseve.	2 orë në ditë- në vend të minimumit prej katër orësh, sipas KKK-së.
	Koha e mësimit në shkollat e arsimit parauniversitar (AP).	Mungesa e hapësirave shkollore në zonat urbane. Neglizhenca në zonat rurale. Mungesa e politikave të qarta.	Rreth 530 orë në vit-ndër më të ulëtat në rajon dhe në Evropë.
	Prania e dhunës fizike në shkolla.	Mungesa e veprimit konkret dhe të vendosur nga autoritetet arsimore	Indikacione të forta për ekzistimin e dhunës fizike. Të dhënat dhe informacionet janë siguruar nga MASHTI-SMIA.

		(përfshirë inspektimin). Mos reagimi i organeve drejtuese dhe arsimore të shkollës. Mungesa e ndërgjegjësimit të prindërve dhe i personelit mësimdhënës. Një tendencë për të mbuluar rastet e dhunës për hir të "paqes".	Rastet e raportuara në polici. Duhet të hulumtohet edhe më shumë kjo dukuri.
Arsimi i përgjithshëm parauniversitar	Prania e diskriminimit.	Performanca e nxënësve RAE në shkollim.	Performanca e ulët në të gjithë sistemin. Pamundësia për t'u regjistruar në shkolla më të mira (në gjimnaz dhe në shkollë të mjekësisë). Pranimi i bindjes se RAE janë "të paracaktuar" të mos performojnë më mirë.
		Sigurimi i teksteve shkollore për nxënësit që mësojnë në gjuhën boshnjake dhe turke.	Nxënësit dhe mësimdhënësit janë mësuar me mungesën e teksteve në gjuhët e tyre. Problemi vazhdon prej vitesh.
Arsimi fillor, mesëm i ulët dhe mesëm i lartë - Rëndësia e arsimit	Rëndësia e ulët, deri e papërfillshme, e arsimit për zhvillimin e potencialit të nxënësve.	Mungesa e arsimit cilësor. Performanca (e dobët) e sistemit. Shërbime të kufizuara arsimore, profesionale dhe mbështetëse për nxënësit në shkolla.	Shkollimi i ofruar kufizohet në mësimdhënie dhe bartje të njohurive. PISA 353 pikë – më e ulëta në rajon dhe në Evropë. TIMMS – ndër dhjetë vendet me rezultatin më të ulët në botë. IKNJ – 57 % e produktivitetit të mundshëm. IZHNJ – 0.741; shumë i ulët dhe duke u përkeqësuar. 76% analfabetizëm funksional dhe duke u përkeqësuar. 5.5 vite të humbura në 13.2 vite të shkollimit efektiv të pritshëm. Vlerat e treguesit duke u përkeqësuar për shkak të COVID-19.

			Koha mësimore në shkolla ndër më të shkurtrat në rajon dhe në Evropë.
	Cilësia e arsimit të ofruar për nxënësit me aftësi të kufizuara.	Mungesa e shërbimeve rehabilituese dhe e ndërhyrjes shumëdisiplinore. Mungesa e resurseve në komuna. Mungesa e trajnimit për mësime ndërkohë.	Numri shumë i ulët i nxënësve të vlerësuar nga Ekipet Komunale të Vlerësimit. Ilustrim: Vetëm 1 nga 47 nxënës me vlerësim pedagogjik në një shkollë.
Arsimi i mesëm i lartë	Përfshirja e nxënësve joshumicë (veçanërisht të atyre RAE).	Çështjet shoqërore dhe ekonomike. Mungesa e një qasjeje sistematike.	Rënie e madhe e statistikave të pjesëmarrjes krahasuar me arsimin fillor (1-9). 5.5 vite të humbura në 13.2 vite të shkollimit të pritsëm kanë të bëjnë kryesisht me këtë nivel arsimor.